



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomiks”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Epoka”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Doriana Matraku (Dervishi)

2. Prof. Asoc. Elida Liko


Tetor/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Ekonomiks” ofruar nga Institucioni i Arsimit të
Lartë “Epoka”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Epoka
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Ekonomiks”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 281, datë 12.03.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër nr. 312, datë 27.07.2012
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër nr. 54, datë 10.07.2017
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19 PAE/ 9 PAK ¹
18	Numri i studentëve:	190 ²
19	Komente / të tjera:	-

¹ Viti akademik 2022-2023

² Studentë të regjistruar për herë të parë nga viti akademik 2017-2018 deri në vitin akademik 2022-2023




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks, ofrohet nga Universiteti EPOKA, që ka ushtruar veprimtarinë akademike që prej vitit 2008, bazuar në Vendimin nr. 281, datë 12.03.2008. Universiteti EPOKA aktualisht përbëhet nga tre fakultete:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinjerisë
2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Programi i studimit, është riorganizuar bazuar në Urdhërin nr. 312 datë 27.07.2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për riorganizimin e programeve të studimit Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Bachelor (B.Sc.) që realizon 180 kredite Evropiane dhe me kohëzgjatje 3 vite akademike. Riorganizimi i programit të studimit, Bachelor në Ekonomiks, është bërë me qëllim plotësimin e kërkesave të tregut të punës në vend me specialistë në fushën e ekonomiksit, që kanë njohuri të konsoliduara jo vetëm teorike por dhe aftësi përpunuese dhe analizuese shumë të mirë të dhënash.

Veprimtaria akademike e programit të riorganizuar ka filluar në vitin akademik 2012-2013. Programi ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze, në përputhje me nivelin e gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Njësia përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e këtij programi studimi është Departamenti i Ekonomiksit, e cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Programi Bachelor në Ekonomiks është akredituar për herë të parë me Vendim nr. 54, të Bordit të Akreditimit, me një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike (6 semestra) me afat vlefshmërie të akreditimit të programit të studimit 09.07.2023.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përbëhet nga:

1. Departamenti i Administrim Biznesit
2. Departamenti i Ekonomiksit
3. Departamenti i Financë -Bankë

Për realizimin e programit të studimit, kontribuojnë pedagogë nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe Departamenti i Financë -Bankë gjithashtu edhe Pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Rreth 67 përqind e stafit akademik që jep mësim në këtë program studimi është me kohë të plotë.

Programi Bachelor në “Ekonomiks” është ndërtuar me qëllim plotësimin e nevojave të tregut të punës për ekonomistë të kualifikuar. Programi i studimit i përgatit studentët me njohuri teorike dhe aftësi të forta statistikore duke u fokusuar në lëndë si matematike, statistika, ekonometria dhe aplikimi i tyre në teorinë ekonomike. Studentët zhvillojnë të menduarin kritik, aftësi kërkimore, aftësi për ndërtimin dhe prezantimin e argumentit për zgjidhjen e

problemeve. Programi i studimit gërsheton njohuritë ekonomike me ato të fushës të ligjeve, fushën e politikës si në nivel global ashtu edhe rajonal.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Universiteti EPOKA në Tiranë, ka aplikuar për nisjen e procedurës së ri akreditimit të programit të studimit Bachelor në Ekonomiks, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, për programin e studimit bachelor në Ekonomiks.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti EPOKA në Tiranë, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As. Dr. Doriana Matraku (Dervishi) dhe Prof. As. Dr. Elida Liko. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj. Vizita në Universitetin EPOKA në Tiranë u realizua në datën 6 dhe 7 Korrik 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekononike dhe Administrative, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.54, datë 10.07.2017 janë:

1. Të rritet pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe mbështetja financiare e institucionit për pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Të shihet mundësia e gjetjes të burimeve të jashtme për zbatimin e projekteve kërkimore;
3. Të rritet bashkëpunimi me institucione vëndase dhe të huaja në kuadër të kualifikimit të stafit akademik.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni si dhe vizita e kryer në Universitetin Epoka, konstaton se:

- **Projekte me financim të brendshëm**, shtojcë 21, janë deklaruar 5 projekte me kohëzgjatje 2 vjecare, pa specifikuar periudhën e implementimit të projektit (koha e nisjes dhe zbatimit të projektit), aktivitetet që mbulojnë këto projekte, buxheti I akorduar nga institucioni për zbatimin e projektit.

Në këto projekte, gjithmonë bazuar ne shtojcë 21, janë angazhuar 5 Phd student nga të cilët GVJ konstaton se vetëm njëri prej tyre është PAE në Departamentin e Ekonomiksit.

- **Projekte me financim të jashtëm**, GVJ konstaton se institucioni ka aktiv tre projekte:
 - a) projekti COWEB, projekti i Erasmus + KA2 për ndërtimin e kapaciteteve të arsimit të lartë i mbështetur nga Bashkimi Evropian (shkurt 2023 -janar 2026)
 - b) projekti Erasmus + nr. 618975-EPP-1-2020-1-BA-EPPKA2-CBHE-JP, për universitete të qendrueshme për përmirësimin e punësimit (2021-2023).
 - c) Module Jean Monnet, për integrimin në BE të Ballkanit Perëndimor (2022-2025)
- Ka përfunduar 6 projekte Erasmus + për periudhën 2015-Janar 2023 në nivel institucioni.
- Ka përfunduar 1 projekt Horizon (2017-2021)
- Ka përfshirje të anëtarëve të departamentit në projekte COST Action, por GVJ vlerëson se këto janë projekte individuale.
- **Pjesëmarrje e stafit në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.** GVJ konstaton se pedagogët e angazhuar në programin e studimit Bsc në Ekonomiks, kanë marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare të financuar nga institucioni (bazuar në shtojcë 25

dhe shtojcë 71 tabela 19) por në pasqyrat financiare të institucionit Epoka konkretisht tabela 18, shtojcë 71, në zërin e shpenzimeve nuk ka të përcakuar buxhet për këto aktivitete.

GVJ nuk ka informacion të plotë në lidhje me këtë rekomandim. Nuk mund të themi që ka një rritje të shpenzimeve për zërin e konferencave apo botimeve kombëtare dhe ndërkombëtare pasi nuk janë të pasqyruara në buxhet.

GVJ konstaton se ka një rritje të të ardhurave të siguruara nga grante projekte dhe kontrata për periudhën 2020-2023. Nuk ka informacion të detajuar për angazhimin e stafit akademik të këtij programi studimi në projektet ndërkombëtare të institucionit.

GVJ konstaton se rekomandimi 1 është përmbushur pjesërisht.

2. GVJ konstaton:

- Bazuar në shtojcë 71, tabela 18, vërejmë se institucioni ka një rritje të të ardhurave në zërin "Grante, projekte dhe kontrata për vitet 2020-2023".

GVJ konstaton se rekomandimi 2 është përmbushur plotësisht.

3. GVJ konstaton:

- Në kuadër të kualifikimit të stafit akademik dhe të institucionalizimit të institucionit, mbështetur në të dhënat e shtojcës 23 dhe 24, Departamenti i Ekonomiksit, GVJ konstaton se ka aktive marrëveshje bashkëpunimi me Universitete brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve kemi shkëmbim të stafi akademik për mësimdhënie, trajnim për stafin administrativ dhe shkëmbime të studentëve.

GVJ konstaton se rekomandim 3 është përmbushur plotësisht.

MEMO

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit vlerëson angazhimin e tyre të menjëhershëm në adresimin e disa prej gjetjeve të konstatuara nga GVJ dhe plotësimin e dokumentacionit për një pjesë të tyre. GVJ lidhur me komentet e dërguara nga GVB sqaron si vijon:

Komente mbi rekomandime nga akredimi i mëparshëm:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim në lidhje me informacionin për mbështetjen e stafit në aktivitete shkencore pas akreditimit të parë. Në pasqyrat financiare, janë të pasqyruara të ardhurat e Universitetit EPOKA nga projektet dhe kontratat duke filluar nga viti akademik 2020-2021, para këtij viti akademik ky zë nuk është në buxhetet tek të ardhurat. Për të gjithë vitet akademike, buxheti ka zërin paga, shpenzime, investime dhe taksa të pasqyruar në tabelat financiare. Ne si GVJ nuk mund të shprehemi nëse zëri shpenzime është për aktivitete shkencore të stafit apo dhe shpenzime të tjera operative. Për këtë arsye jemi shprehur se mungon informacioni i detajuar.

Standardin II. 2, kriteri 2 dhe standardin II. 3, kriteri 4

Komenti GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim dhe mbështet konstatim e pasqyruar në raport bazuar në syllabusin e lëndëve individuale si dhe në planin mësimor. Syllabusi dhe plani mësimor, kanë të përcaktuar vetëm orë leksioni. Orë laboratorit nuk ka të përcaktuar për asnjë lëndë.

GVJ nuk mund të shprehet për orët e seminarit/ ushtrimeve/ laboratorëve pasi nuk janë të pasqyruara në syllabusin e lëndëve.

Standardin II. 3, kriteri 1:

Komenti GVJ:

GVJ, **nuk ndryshon** qëndrim dhe konstaton shqetësues faktin që personeli akademik i kategorisë "Asistent lektor", mbulon një peshë të konsiderueshme të lëndëve të ofruara nga programi i studimit, duke qenë titullar lënde. Më konkretisht për vitin akademik 2022 -2023, 12(dymbëdhjetë) lëndë me detyrim të këtij programi studimi, kanë titullar lënde pedagogë me master të shkencave (shtojca 18). Bazuar në planin mësimor, për vitin akademik 2022 -2023, programi i studimit i shtrirë në tre vite akademike ofron gjithsej 27(njëzet e shtatë) lëndë me

detyrim (shtojca 13). Mbulohen nga "Asistent lektor", si titullarë lënde 44% e lëndëve me detyrim. Po të konsiderojmë dhe lëndët me zgjedhje, raporti përkeqësohet.

Standardin III. 4, kriteri 5:

Komenti GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim, ka mangësi në dokumentacion e administruar dhe informacionin e publikuar për projektet në web. Në faqen e internetit dhe linkun e dërguar, mungojnë të dhënat për angazhimin e stafit të programit të studimit në këto projekte, si dhe kontributin e tyre.

Standarti IV.1, Kriteri 1:

Komenti GVJ:

Në lidhje me përgjigjen e dhënë nga GVB dhe dokumentin e shtuar në platformë GVJ **nuk ndryshon** qëndrimin e tij pasi dokumenti I dorëzuar nuk tregon asgjë në lidhje me ngarkesën mësimore por vetëm shpërndarjen e grupeve sipas stafit akademik. Dokumenti gjithashtu nuk I është adresuar Zyrës së Burimeve Njerëzore për të cilën është shprehur dhe GVJ.

Kriteri 2:

Komenti GVJ:

GVJ konstaton se ngarkesa mësimore ndahet sipas nevojave të departamentit dhe është e ndryshme pamvarësisht titullit apo gradës shkencore të stafit akademik. Ky është një konstatim dhe GVJ **nuk e ndryshon** qëndrimin për këtë. GVJ nuk është shprehur për shkelje të akteve ligjore apo nënligjore në fuqi. E gjejmë të pavend reagimin e GVB për këtë kriter.

Kriteri 3 dhe Kriteri 6:

Komenti GVJ

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim në lidhje me këto kriteret. GVB pranon që CV e stafit nuk janë të përditësuara sepse CV ruhen në departament. Dokumenti shtojcë 84, nuk tregon përditësimin e dokumentave por është vetëm një template (praktike). GVJ kërkon dokumenta të përditësuara dhe jo template të përgjithshme. Nëse Departamenti do e kishte këtë informacion, duhet ta kishte bërë të aksesueshëm për GVJ.

Në lidhje me këto kritere, edhe pas dorëzimit të draft raportit nga GVJ dhe komenteve ng GVB, institucioni nuk ka dorëzuar CV të përditësuara por vetem komunikimin e Zyrës së Burimeve Njerëzore me stafin ku I kërkon info CV të përditësuara (shtojca 4).

Kriteri 4:

Komenti GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim në lidhje me këtë kriter. GVJ e ka shprehur qartë në RVJ procedurën që ndjek Universiteti Epoka dhe ne jemi shprehur që nuk ka kritere specifike. GVB dhe në komentin e bërë për këtë kriter nuk jep kritere specifike për stafin akademik të rekrutuar. GVB shprehet që përzgjedhja bëhet nisur nga natyra, modulet, përmbajtja e lëndës apo programit të studimit por kjo nuk garanton marrjen e stafit më cilësor.

Kriteri 5:

Komenti I GVJ:

Mbështetur në dokumentin shtesë të dorëzuar nga Institucioni, rezulton se në Departamentin e Ekonomiksit për vitin 2022-2023 rezulton vetëm një student në listën e stafit ndihmës akademik dhe dy studentë në vitin 2021-2022. RVJ **ndryshon pjesërisht** për këtë kriter.

Ndryshimi në raport është: *Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 5, rezulton se Departamenti I Ekonomiksit për vitin 2022-2023 ka pranuar një student si asistent ndihmës akademik. Nuk kemi informacion nëse ky student është I përfshirë në këtë program studimi.*

Standarti IV.3 Kriteri 1:

Komenti GVJ:

RVJ **nuk ndryshon** për këtë kriter pasi GVB bie dakort me sygjërimin e GVJ për këtë kriter.

Kriteri 2 & 8:

Komenti I GVJ:

GVJ **ndryshon** qëndrim në lidhje me kriterin 2 & 8, pas dorëzimit të dokumentave shtesë mbi praktikën e pasurimit të bibliotekës.

Ndryshimi në raport është: *Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 10, rezulton se Universiteti Epoka ka një procedurë të miratuar dhe të aplikuar të pasurimit të bibliotekës sipas*

nevojave të stafit akademik mbështetur në kërkesat e studentëve apo objektivat e vendosura. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit pr përmirësimin e infrastrukturës s bibliotekës.

Standarti IV.5 Kriteri 3:

GVJ **ndryshon** qëndrim në lidhje me këtë kriter. GVB ka dorëzuar raportin e auditit në shtojcë plotësuese 2.

Ndryshimi në raport është: *Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 2. rezulton se Universiteti Epoka ka kryer në mënyrë periodike auditin e jashtëm.*

Kriteri 4:

Komenti I GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim, Institucioni ka dorëzuar pasqyrat shpenzime - të ardhura për këtë program studimi, por kriteri ka të bëjë me raportimet e buxhetit në department. Dokumenti shtesë nuk jep këtë informacion. Vet GVB në RVB nuk është shprehur në lidhje me kriterin 4.

Kriteri 5:

Komenti GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim.

Standarti V.4. Kriteri 5:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim. GVB ka dorëzuar në dokumentat plotësuese një raport vjetor të institucionit. Kriteri ka lidhje me njësinë bazë pra departamentin dhe raportet që departamenti përpilon në lidhje me studentët e programit të studimit, cilësinë e tyre, punësimin etj.

Standarti V.5. Kriteri 4.

Komenti GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim për këtë kriter. Dokumenti I kërkuar në këtë kriter nuk është paraqitur as në dokumentat shtesë. Dokumenti I kërkuar lidhet me ankesat e studentëve gjatë procesit të provimit jo me pyetësorët që plotësojnë studentët për modulin apo stafin akademik.

Standarti VI.1 Kriteri 1:

Komenti GVJ:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim në lidhje me këtë kriter. GVB shprehet në komente që Strategjia e re e Institucionit është në fazë finale për miratimin në Senatin Akademik apo dhe në Bordin e Administrimit. Në këtë fazë të zhvillimit të Strategjisë së Institucionit, GVB mund të kishte dorëzuar një document për ta treguar këtë psh, Ngritja e grupit të punës për hartimin e Strategjisë, ose një document që të tregojë kalimin apo diskutimin e strategjisë në njësitë bazë apo komisionet e ndryshme.

Kriteri 5:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim. GVB në dokumentin shtesë nuk ka dhënë mënyrën si departamenti apo institucioni promovon shembuj të praktikave të mira, që nxitin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. GVB ka dhënë shembull të pyetësorit që plotësojnë studentët për stafin akademik ose modulin.

Standarti VI.2 Kriteri 2:

GVJ **ndryshon** qëndrim pas dorëzimit të dokumentit shtesë ku jepet Vendim I Senatit mbi ngritjen e Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë dhe përfshirjen në këtë grup të një student alumni dhe një eksperti të jashtëm.

Ndryshimi në raport është: Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 8, rezulton se Universiteti Epoka nëpërmjet Vendimit të Senatit ka ngritur Komisionin e Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë për përfshirjen në këtë grup të një student alumni dhe një eksperti të jashtëm.

Kriteri 4:

GVJ **nuk ndryshon** qëndrim sepse ashtu sic theksuam dhe më lart në Standarti V.4. Kriteri 5 departamenti nuk ka dorëzuar asnjë raport.

Standarti VI.4 Kriteri 3:

Institucioni ka dorëzuar document shtesë 8, por ashtu sic theksohet në komentin e GVJ, anëtarët e Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë, janë dhe staf akademik me kohë të plotë pra kryejnë një ngarkesë të madhe mësimore. Në Statutin e Universitetit Epoka neni 35, jepen detyrat e këtij komisioni por jo roli i secilit anëtar dhe detyrat që kryejnë në këtë komision. GVJ **nuk ndryshon** qëndrim në lidhje me këtë kriter.

Standarti VI.5 Kriteri 5:


GVJ **ndryshon** qëndrim pas dorëzimit të dokumentit plotësues që tregon aktivitetet e kryera me stafin apo studentët.

Ndryshimi në raport është: *Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 9, rezulton se Universiteti Epoka kryen aktivitete me stafin dhe studentët për rëndësinë e sigurimit të cilësisë.*

Pikat e dobëta

Ndryshon Pika 5: të hiqet pasi institucioni ka sjellë dokumentat e cituara.


5. Mungesa e një sërë dokumentash mbështetëse në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm. (**Standardi VI.5, kriteri 5**) dhe (**Standardi VI.2 , kriteri 2, 4**) dhe (**Standardi IV.5, kriteri 5**)



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Ekonomiks”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi L1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti EPOKA, ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, si dhe janë konform ruajtjes së vlerave kulturore kombëtare.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të Parë në Bachelor në “Ekonomiks” ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit i cili është pjesë e Fakultetit të “Shkencave Ekonomike dhe Administrative” të Univeritetit EPOKA, është hartuar dhe implementuar në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nenin 74, te Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore • Statutin e Universitetit Epoka • Urdhërin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës të Republikës të Shqipërisë nr. 312, datë 27.07.2012, për riorganizim të programit të studimit, dhe • Akreditimi fillestar me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 54 datë 10.07.2017 <p>2. Statuti 3. Strategjia e Universitetit EPOKA 4. Rregullore e Universitetit EPOKA</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, të Universitetit EPOKA, në përgjegjësi të Departamentit të Ekonomiksit është program i Ciklit të parë të studimeve, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me një total prej 180 kredite (ECTS). Ky program është riorganizuar bazuar në Urdhërin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 312, datë 27.07.2012. Programi është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 54 datë 10.07.2017.</p> <p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e Univeritetit EPOKA të shprehur në Statutin dhe në Rregulloren e IAL, si dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij dhe qëllimit të zhvillimit institucional.</p> <p>GVJ vlerëson se ky program iu ofron studentëve një diplomë universitare, e cila do t’u japë atyre njohuritë, aftësitë akademike dhe praktike, të mjaftueshme për të qenë të aftë për tregun e punës.</p>




	<p>2. Statuti 3. Strategjia e Universitetit EPOKA 4. Plani strategjik i Departamentit të Ekonomiksit 2017-2022 5. Rregullore e Universitetit EPOKA</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks” ofrohet në përputhje me Statuginë e zhvillimit të Universitetit EPOKA, Statutin dhe Rregulloret e Universitetit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p> <p>Vizioni i Universitetit EPOKA, është përgatitja e studentëve që do të jenë lider në fushën e edukimit, kërkimit dhe zhvillimit, si dhe ofrimi i shërbimeve shoqërisë Shqiptare duke ofruar zgjidhje për problemet konkrete me të cilat përballet.</p> <p>Departamenti i Ekonomiksit, përgjegjës për këtë program studimi, është angazhuar në pajisjen e studentëve me të menduarit kritik për të përballuar debate publike në fushën e ekonomiksit.</p> <p>Programi i studimit garanton dhe respekton lirinë akademike, ka rritur përdorimin e teknologjisë të inovacionit në mësimdhënie, ka rritur orjentimin e kërkimit shkencor drejt nevojave konkretë të ekonomisë Shqiptare dhe më gjerë, duke synuar përmirësimin e cilësisë në fushën e ekonomiksit.</p> <p>2. Statuti 3. Strategjia e Universitetit EPOKA 4. Plani strategjik i Departamentit të Ekonomiksit 2017-2022</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashëm konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomiksit që ofron këtë program studimi, është krijuar në vitin 2008 dhe ka një eksperiencë 15 vjeçare në mësimdhënie në këtë program studimi • Departamenti i Ekonomiksit ofron programe studimi në gjuhën angleze aktive në të tre ciklet. Masteri shkencor për Ekonomiks është liçensuar me VKM nr. 58, datë 28.08.2009, është akredituar VBA nr. 58, datë 28.09.2018. Doktoratura me profil “Ekonomiks” është liçensuar me UMASH nr. 565, datë 19.12.2012, është akredituar BA nr. 21, datë 19.05.2017. • Universiteti Epoka ofron 10 programe bachelor, 8 programe master shkencor, 9 programe master profesional, 2 programe të integruara të ciklit të dytë dhe 6 programe doktorature. • Infrastruktura në funksion të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative është bashkëkohore dhe e pajisur me teknologjinë e fundit • Staf akademik është i motivuar dhe i kualifikuar. Ka një gërshetim midis stafit të ri të angazhuar në programin e studimit dhe atij me përvojë të qëndrueshme pranë kësaj IAL. <p>Programi Bachelor në “Ekonomiks” i ofruar nga Departamenti i Ekonomiksit, është riorganizuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend nga program bachelor në Ekonomiks katër vjeçar në program</p>




	<p>bachelor në ekonomiks tre vjeçar, me Urdhër nr. nr. 312, datë 27.07.2012. Programi është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 54 datë 10.07.2017. Departamenti i Ekonomiksit është pjesë e Fakultetit të “Shkencave Ekonomike dhe Administrative”, i cili është i organizuar në tre njësi themelore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i “Administrimit të Biznesit”, 2. Departamenti i “Ekonomiksit”, 3. Departamenti i “Financë -Bankë”. <p>2. Statuti 18. Syllabuset 40. CV e stafit akademik</p>		
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasi fikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi Bachelor në “Ekonomiks” është në përputhje të plotë me fushën e programeve që ofron Departamenti i Ekonomiksit. Programi ofron edukim përmes mësimdhënies efçente duke përgatitur individë të aftë për tregun e punës. Studentët pajisen me njohuri të konsoliduara teorike dhe aplikative, duke mundësuar kryerjen e analizave të zhvillimeve ekonomike në vend, ndërtimin e modeleve të thjeshta si dhe interpretimin e rezultateve. Aftësimi i studentëve me të menduarin kritik, është një nga objektivat kryesore të Departamentit të Ekonomiksit.</p> <p>Ky program studimi zhvillohet me kohë të plotë, zgjat 3 vite akademike, siguron 180 kredite dhe i përket nivelit të gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe bazohet në udhëzimet e direktivave kombëtare dhe Evropiane. Programi jep mundësi për të ndjekur programe të ciklit të dytë.</p> <p>3. Strategjia e Universitetit EPOKA 5. Rregullore e Universitetit EPOKA 4. Plani strategjik i Departamentit të Ekonomiksit 2017-2022</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga Universiteti EPOKA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi Bachelor në “Ekonomiks”, i përmbush më së miri misionin dhe objektivat e Universitetit EPOKA, të shprehura në të gjitha dokumentat e tij. Ky program studimi ruan interesat dhe vlerat kombëtare.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit,</p>	<p>Në funksion të realizimit të programeve të tij të studimit, Universiteti EPOKA ka hartuar strukturën organizative, në të cilën përcaktohet vendosja e detyrave apo aktiviteteve që lejon funksionimin e duhur të çdo departamenti, me synimin e ofrimit dhe sigurimit të cilësisë në kuadër të realizimit të programit të studimit. Universiteti EPOKA ka hartuar</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>marrjes së përgjegjësiave përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>rregullore, politika, procedura, udhëzues dhe manualë, përmes të cilave mbikqyr mbarëvajtjen e tyre.</p> <p>Bazuar në nenin 11, të Statutit të Universitetit Epoka, Fakulteti Shkencave Ekonomike dhe Administrative, është njësi kryesore e Universitetit EPOKA, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura.</p> <p>Në programin bacheror në “Ekonomiks”, janë angazhuar pedagogë që i përkasin departamenteve të ndryshme të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, në lëndë si “Kontabilitet Financiar”, “Hyrje në Biznes”, “Menaxhim operacionesh”, janë angazhuar pedagogë të Departamentit Financë -Bankë dhe Departamentit të Administrim Biznesit. Pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale janë të angazhuar gjithashtu në këtë program studimi. Lëndët “Hyrje në Drejtësi”, “Ligji i biznesit”, mbulohe nga pedagogë të Departamentit të Ligjeve. Pedagogë nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare mbulojnë gjuhët e huaja që ofrohen në kuadër të këtij programi studimi. Pedagogë të Qendrës për Studime Europiane janë të angazhuar në lëndë “Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit”, “Kërkimi në Marketing”, etj.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks” është në drejtimin e Departamentit të Ekonomiksit. Bazuar në nenin 12 të Statutit, Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit, për sigurimin e cilësisë të brendshme. Departamenti përcakton ngarkesën mësimore dhe monitoron personelit nëpërmjet instrumentave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Në mënyrë periodike, Departamenti organizon mbledhje në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Për çdo vit akademik Departamenti harton raportin vjetor të punës, duke vendosur objektiva për fillimin e vitit të ri akademik dhe masat që duhet të ndërmerren me qëllim realizimin e këtyre objektivave.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e administruar dhe vizitën në institucion, konstatojmë se Fakulteti i “Shkencave Ekonomike dhe Administrative” dhe, Departamenti i “Ekonomiksit”, kryejnë analiza periodike mbi mësimdhënien dhe aktivitetin kërkimor shkencor të personelit akademik.</p> <p><i>2. Statuti i Universitetit Epoka</i> <i>13. Programi mësimor</i> <i>20. Raporti Vjetor i Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Ndërkombëtarizimin konsiderohet si një komponent thelbësor i zhvillimit dhe misionit të Universitetit EPOKA. Departamenti i Ekonomiksit, përgjegjës për programin e studimit, ka një staf akademik ndërkombëtar me kohë të plotë nga SHBA, Greqia, Turqia dhe Shqipëria.</p> <p>Në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, Universiteti EPOKA ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase dhe ndërkombëtare. Marrëveshjet në kuadrin e programit Erasmus +, kanë angazhuar stafin akademik, stafin administrativ dhe studentët e këtij programi shkëmbimi. Procesi i mësimdhënies në gjuhën angleze të programit të studimit, lehtëson shkëmbimet. Nga dokumentacioni i administruar dhe vizita në institucion, konstatojmë se stafi akademik ka marrë pjesë në programet Erasmus + për mësimdhënie dhe stafi</p>




	<p>administrativ i angazhuar në këtë program studimi, në programet Erasmus + për trajtim. Disa nga Universitetet që ka marrëveshje për këtë program studimi, janë: Universitetin Salerno në Itali, Universitetin e Studimeve Ndërkombëtare, Romë, Universitetin Lille Francë, Universiteti Loud në Poloni, Universiteti Pitesti Rumani, Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Gjermani etj.</p> <p>EPOKA është lider në projektin COWEB, projekti i Erasmus + KA2 për ndërtimin e kapaciteteve të arsimit të lartë i mbështetur nga Bashkimi Evropian. Në këtë projekt bëjnë pjesë 10 universitete partnere nga 7 vende të ndryshme. Kohëzgjatja e projektit shkurt 2023 -janar 2026.</p> <p>EPOKA ka marrë pjesë në 6 projekte Erasmus+ si partnere me institucione të tjera të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, tashmë të përfunduara.</p> <p>Universiteti Epoka është partner në projektin :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Erasmus + nr. 618975-EPP-1-2020-1-BA-EPPKA2-CBHE-JP, për universitete të qendrueshme për përmirësimin e punësimit. Kohëzgjatja e projektit janar 2021 -nëntor 2023 <p>EPOKA është i përfshirë në projektin, Module të Jean Monnet, për integrimin në BE të Ballkanit Perëndimor.</p> <p>EPOKA ka qenë universitet partner në projektin Horizon 2020. Kohëzgjatja e projektit tetor 2017 -dhjetor 2021.</p> <p>Nga vizita në institucion konstatoam se, pedagogët përdorin kërkimin e tyre shkencor për të ilustruar leksionet me raste studimore praktike.</p> <p>Krahas marrëveshje në kuadër të programit Erasmus +, pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar në disa projekte individuale ndërkombëtare Cost Action.</p> <p>www.projects.epoka.edu.al</p> <p><i>3. Strategjia e Universitetit EPOKA</i></p> <p><i>23. Raport për ndërkomtarizimin dhe perspektivën</i></p> <p><i>24. Pjesëmarrja në Erasmus e studentëve dhe stafit</i></p> <p><i>21. Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Me qëllim realizimin e praktikës profesionale, si dhe krijimin e mundësive për punësimin potencial të studentëve, Universiteti Epoka ka nënshkruar 69 marrëveshje në kuadrin e IAL, nga të cilat vetëm për këtë program studimi janë nënshkruar gjashtë marrëveshje.</p> <p>Pjestarë të institucioneve me të cilat IAL ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi, janë të angazhuar në dhënien e leksioneve, si lektorë të ftuar në kuadrin e lëndëve të ndryshme me qëllim ilustrimin e teorisë me raste studimore praktike. Numri i aktiviteteve në nivel Fakulteti, për periudhën në analizë për këtë program studimi është 27.</p> <p><i>71. Tabela përmbledhëse (tabela 5, tabela 19)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit, në fund të vitit akademik përgatit raportin vjetor të Departamentit i cili i paraqitet Dekanit të Fakultetit. Në këtë raport bëhet një analizë e mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe shërbimit të komunitetit.</p>

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Programi i studimit realizon pyetësorë për alumni, me qëllim që të marrë mendimin e tyre për përshtatjen e njohurive të fituara gjatë studimeve bachelor me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit merr mendimin e kompanive dhe institucioneve shtetërore dhe private me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të praktikës/ punësimit pranë institucionit të tyre. Qëllimi është marrja e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Pyetjet drejtuar kompanive, institucioneve shtetërore dhe private janë të strukturuar në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aftësitë ndërpersonale të studentëve - Aftësitë e tyre për të organizuar punën - Aftësinë e tyre që të punojnë në grup - Gadishmërinë e tyre për të mësuar në vendin e punës - Sa të kënaqur janë në lidhje me performancën e studentëve në punë - Nëse do të vaxhdojnë të punësojnë studentë të Universiteti Epoka <p>20. Raport vjetor i departamentit të Ekonomiksit 16. Pyetësor Alumni 45. Pyetësor për kompanitë</p>								
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe me institucione publike dhe private. Këto marrëveshje kanë mundësuar mobilitetin e studentëve dhe sfatit të programit të studimit për mësimdhënie dhe trajnim.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;"></th> <th style="width: 25%;"></th> <th style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks, është organizuar bazuar në nenin 73, pika 1, të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, me 180 kredite (ECTS) në total me një kohëzgjatje prej 3 vitesh.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit, çdo vit akademik është i organizuar në dy semestra me një ngarkesë të barabartë prej 30 ECTS për çdo semestër, ose 60 ECTS në një vit akademik, me një total prej 180 ECTS.</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Plani mësimor përmban të gjithë veprimatrinë formuese të përcaktuar nga shtojca nr. 1, VKM nr. 41 datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.</p> <p>13. Plani mësimor 18. Syllabuset</p>																								
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit i pajis studentët me njohuri të konsoliduara në nivel mikroekonomik dhe makroekonomik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët marrin njohuri të sjelljes së konsumatorit dhe firmave të biznesit, vendimarrjen në kushte të pasigurisë. - Studentët marrin njohuri për mënyrën sesi funksion ekonomia në tërësi në periudhën afat shkurtër dhe afat gjatë, modelet kryesore që përdoren për analiza ekonomike, lidhjen midis variablave të ndryshëm. <p>Bazuar në kurset që ofrohen si "Metoda kërkimi në shkencat sociale", "Statistik II", "Ekonometri" studentët janë të aftë të zhvillojnë analiza të thjeshta dhe të bëjnë parashikime.</p> <p>Me qëllim njohjen e politikave publike që zbatohen në Shqipëri, programi i studimit ofron si lëndë me zgjedhje "Qeveria dhe politika publike në Shqipëri".</p> <p>Krahas mësimin që zhvillohet në gjuhën angleze, programi i studimit ofron si lëndë me zgjedhje edhe katër gjuhë të huaja "Frengjisht", "Gjermanisht", "Italisht" dhe "Turqisht". Kjo përbën një avantazh, pasi në vendin tonë ka shumë kompani të huaja që veprojnë dhe njohja e gjuhëve të huaja lehtëson komunikimin në biznes.</p> <p>13. Plani mësimor 18. Syllabuset</p>																								
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaria formuese e programit të studimit është e përcaktuar, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.</p> <table border="1" data-bbox="582 1444 1412 1930"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi i komponentit mësimor</th> <th>Bachelor sipas shtojcës 1, VKM</th> <th>Ofruar nga programi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë bazë</td> <td>15% -20% (kredite)</td> <td>16.67%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>50% -55% (kredite)</td> <td>54.44%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese</td> <td>12% -15% (kredite)</td> <td>11.67%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë Plotësuese</td> <td>10% -15% (kredite)</td> <td>13.89%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime</td> <td>3% -5%</td> <td>3.33%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Bachelor sipas shtojcës 1, VKM	Ofruar nga programi	A	Lëndë bazë	15% -20% (kredite)	16.67%	B	Lëndë karakterizuese	50% -55% (kredite)	54.44%	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15% (kredite)	11.67%	D	Lëndë Plotësuese	10% -15% (kredite)	13.89%	E	Detyrime	3% -5%	3.33%
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Bachelor sipas shtojcës 1, VKM	Ofruar nga programi																						
A	Lëndë bazë	15% -20% (kredite)	16.67%																						
B	Lëndë karakterizuese	50% -55% (kredite)	54.44%																						
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15% (kredite)	11.67%																						
D	Lëndë Plotësuese	10% -15% (kredite)	13.89%																						
E	Detyrime	3% -5%	3.33%																						



	përmbyllëse	(kredite)	
	Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, konstatojmë se veprimtaria formuese e programit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji.		
	<i>13. Plani mësimor</i>		
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Bazuar planin mësimor, praktika profesionale është e detyrueshme, regjistrohet si kurs i rregullt, zhvillohet në vitin e tretë të studimit, semestri i parë, vlerësohet me 5 ECTS.</p> <p>Diploma nund të mbrohet me temë ose provim përfundimtar, është kurs i detyruar që zhvillohet në vitin e tretë semestri i dytë. Vlerësohet me 6 ECTS.</p> <p>Bazuar në nenin 16, të Rregullores të Universitetit Epoka për programin bachelor, studentët që kanë CGPA më pak se 3.00 nga 4.00 duhet të zhvillojnë provim përfundimtar ndërsa studentët me CGPA më shumë se 3.00 dhe më pak se 4.00 mund të zgjedhin midis provimit ose projektit të diplomimit. Departamenti është përgjegjës për zhvillimin e provimit përfundimtar dhe projektin e diplomimit.</p> <p><i>13. Plani mësimor</i> <i>16. Rregullore e Universitetit Epoka për "Bachelorin dhe Provimet"</i></p>		
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<p>Procedura e pranimit dhe e regjistrimit të studentëve është e përcaktuar në nenin 84 të Statutit. Kuota e studentëve për programin e studimit propozohet nga Senati akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Pranimi i studentëve është në përputhje me pikën 1, neni 74 të ligjit 80/2015. Pranohen kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm, që plotësojnë kriterin e notës mesatare dhe janë shpallur fitues nga departamenti. Aplikimet bëhen me anë të portalit U -Albania.</p> <p>Studentët e huaj janë të detyruar të ndjekin procedurën e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomës. Kriteri i notës mesatare, është i vlefshëm edhe për studentët e huaj, pas njohjes së diplomës.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze, si rrjedhim studentët që aplikojnë për këtë program studimi, duhet të kenë të paktën nivelin B1 të gjuhës angleze, të mbrojtur që i përket një liste provimesh të njohura, e cila është e publikuar.</p> <p>Në rastin kur studimet e shkollës së mesme janë kryer në gjuhën angleze, nuk kërkohet dëshmi e gjuhës.</p> <p>Nëse studentët nuk e disponojnë një dëshmi të njohur të gjuhës angleze, ata i nënshtrohen provimit të anglishtes të organizuar në Universitetin EPOKA.</p> <p>Kriter shtesë është mesatarja e shkollës së mesme minimumi shtatë.</p> <p><i>2. Statuti</i> <i>5. Rregullore themeltare</i> <i>47. Kriteret e pranimit për vitin 2023-2024</i></p>		
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë	<p>Kriteri ligjor i përcaktuar nga pika 2, neni 86, ligji 80/2015, plotësohet. Bazuar në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Ekonomiks konstatojmë se ka përmbajtje të ngjashme në masën 70%.</p>		

<p>përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në Ekonomiks është krahasuar me programin e studimit bachelor në Bankë dhe Financë, i ofruar nga Universiteti EPOKA.</p> <p>Lëndë karakterizuese si përgatitje specifike për bachelorin:</p> <table border="1" data-bbox="574 264 1380 772"> <thead> <tr> <th>Bachelor në Ekonomiks</th> <th>Bachelor në Bankë dhe Financë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>- Mikroekonomi II</td> <td>- Kontabilitet Financiar II</td> </tr> <tr> <td>- Makroekonomi II</td> <td>- Financë publike</td> </tr> <tr> <td>- Ekonomiks pune</td> <td>- Menaxhim Financiar</td> </tr> <tr> <td>- Teoria dhe Politika monetare I dhe II</td> <td>- Institucione dhe tregje financiare</td> </tr> <tr> <td>- Ekonomiks ndërkombëtar I dhe II</td> <td>- Menaxhim dhe analizë kredie</td> </tr> <tr> <td>- Ekonometri</td> <td>- Analizë e raporteve financiare</td> </tr> <tr> <td></td> <td>- Krahasimi i sitemeve bankare</td> </tr> <tr> <td></td> <td>- Financë ndërkombëtare</td> </tr> <tr> <td></td> <td>- Ekonometri Financiare</td> </tr> </tbody> </table> <p>13. Plani mësimor https://baf.epoka.edu.al/home-banking-and-finance-albanian-1761-1976.html</p>	Bachelor në Ekonomiks	Bachelor në Bankë dhe Financë	- Mikroekonomi II	- Kontabilitet Financiar II	- Makroekonomi II	- Financë publike	- Ekonomiks pune	- Menaxhim Financiar	- Teoria dhe Politika monetare I dhe II	- Institucione dhe tregje financiare	- Ekonomiks ndërkombëtar I dhe II	- Menaxhim dhe analizë kredie	- Ekonometri	- Analizë e raporteve financiare		- Krahasimi i sitemeve bankare		- Financë ndërkombëtare		- Ekonometri Financiare
Bachelor në Ekonomiks	Bachelor në Bankë dhe Financë																				
- Mikroekonomi II	- Kontabilitet Financiar II																				
- Makroekonomi II	- Financë publike																				
- Ekonomiks pune	- Menaxhim Financiar																				
- Teoria dhe Politika monetare I dhe II	- Institucione dhe tregje financiare																				
- Ekonomiks ndërkombëtar I dhe II	- Menaxhim dhe analizë kredie																				
- Ekonometri	- Analizë e raporteve financiare																				
	- Krahasimi i sitemeve bankare																				
	- Financë ndërkombëtare																				
	- Ekonometri Financiare																				
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizita në institucion, konstatohet se të gjitha lëndët e ofruara në programin e studimit, janë të koduara sipas dispozitave të pikës 1, neni 86 të ligjit 80/2015, si dhe Udhëzimin me nr. 31, datë 15.01.2022, për “Procedurat për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.”</p> <p>13. Plani mësimor 18. Syllabuset</p>																				
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë.</p> <p>Programi bachelor në “Ekonomiks” është licensuar në baze të VKM nr. 281, datë 12.03.2008. Është riorganizuar nga një program studimi Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në “Ekonomiks” me kohëzgjatje katër vite akademike, në program bachelor (B. Sc.) në “Ekonomiks”, me 180 kredite Evropiane dhe me kohëzgjatje e vite akademike, bazuar në Urdhërin nr. 312, datë 27.07.2012.</p> <p>Programi është akredituar për herë të parë në 7.6.2011 me Urdhërin nr. 260. Ka realizuar akreditim periodik 10.07.2017 bazuar në Vendimin nr. 54 të Bordit të Akreditimit.</p> <p>VKM nr. 281, datë 12.03.2008 Urdhërin nr. 312, datë 27.07.2012 Urdhërin nr. 260, datë 7.6.2011 Vendimin nr. 54, datë 10.07.2017</p>																				
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se program i studimit është i organizuar në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar me</p>																				

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	VKM nr. 879 datë 18.12.2019. Studentët që ndjekin bachelor në "Ekonomiks" përfitojnë njohuri të avancuara teorike dhe analitike, duke u bërë më konkurrues në tregun e punës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit, Bachelor në "Ekonomiks", ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Departamenti i Ekonomiksit.</p> <p>Bazuar në neni 23, ligji 80/2015, Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta, organizohet nga të paktën tri njësi bazë së paku dy prej të cilave janë departamente. Ky kriter ligjor plotësohet. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përbëhet nga tre departamente. Departamenti i Financë - Bankë, Departamenti i Ekonomiksit dhe Departamenti i Administrim Biznesit.</p> <p>Bazuar në nenin 25 të ligjit 80/2015, Departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit, ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore. Konstatohet se ky kriter ligjor plotësohet.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Ekonomiksit (tabela përmbledhëse nr. 1.4; 1.5, 1.6)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Dr.</td> <td>3</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>2</td> <td></td> <td>3</td> <td></td> <td>3</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>7</td> <td>0</td> <td>7</td> <td>0</td> <td>7</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="2">7</td> <td colspan="2">7</td> <td colspan="2">7</td> </tr> </tbody> </table> <p>46. Struktura administrative 71. Tabela përmbledhëse</p>		2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1		1		2		Prof. Asoc.	1		1		1		Dr.	3		2		1		MSc	2		3		3			7	0	7	0	7	0	Totali	7		7		7	
	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof. Dr	1		1		2																																																			
Prof. Asoc.	1		1		1																																																			
Dr.	3		2		1																																																			
MSc	2		3		3																																																			
	7	0	7	0	7	0																																																		
Totali	7		7		7																																																			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për</p>	<p>Nga shqyrtimi i kurrikulës konstatohet se, në planin mësimor të programit të studimit nuk janë të përcaktuara orë laborator, në asnjë nga lëndët e ofruara në program. Në lëndë si "Metoda kërkimi në shkencat sociale", "Statistikë II", nuk janë të parashikuara orë praktike ose laborator.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e praktikës, një personel akademik i Departamentit</p>																																																							

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	mbikqyr realizimin e praktikës mësimore. Zyra e karrierës dhe alumni, siguron informacionin në lidhje me institucionet, kompanitë etj., me të cilat Universiteti EPOKA ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Zyra bën publike të gjitha mundësitë për realizimin e praktikës në faqen zyrtare. <i>13. Plani mësimor</i> <i>77. Rregullore e praktikës profesionale</i>						
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Përgjegjësi i Departamentit, në përputhje neni 54, të Statutit të Universitetit Epoka, është përgjegjës për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe aktivitete të tjera ndër universitare duke siguruar arritjen e objektivave dhe cilësinë. Bazuar në neni 34, të Rregullores të Universitetit Epoka, dhe të nenit 6 të Rregullores për Programin Bachelor, përcaktohet një këshilltar akademik për secilin student, përfaqësues i stafit akademik të departamentit që ofron programin e studimit. Këshilltari akademik ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë periudhës të studimit. Detyra e këshilltarit akademik është të ndihmojë studentin në të gjitha çështjet që lidhen me programin e studimit, si regjistrimi në kurse, për lëndët me zgjedhje etj. <i>5. Rregullores të Universitetit EPOKA</i> <i>7. Rregullore e programit bachelor</i> <i>2. Statuti i Universitetit EPOKA</i>						
Konkluzione	<i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kriteret ligjore, ka në përbërje të saj 7 pedagogë me kohë të plotë nga të cilët 3 mbajnë grada shkencore. Personeli akademik i kategorisë profesor, është rritur në vitin akademik 2022-2023, në tre anëtarë nga dy anëtarë që ka qenë më parë.</i> <i>Programi i studimit, nuk ka orë laboratorit të programuara në asnjë nga lëndët e ofruara, si rrjedhojë nuk ka staf ndihmës akademik të angazhuar për realizimin e orëve të laboratorit. Ndjekja e praktikës profesionale bëhet nga këshilltari akademik, i cili bazuar në Rregulloret e institucionit, është personel akademik me kohë të plotë.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="558 1344 973 1411"></th> <th data-bbox="973 1344 1197 1411">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1197 1344 1418 1411">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="558 1411 973 1456"></td> <td data-bbox="973 1411 1197 1456"></td> <td data-bbox="1197 1411 1418 1456">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në nenin 12, të Statutit të Universitetit Epoka, Departamenti i Ekonomiksit, është njësia bazë përgjegjëse për mësimdhënien dhe për sigurimin e cilësisë të programit të studimit. Bazuar në nenin 54 të Statutit, Drejtuesi i Departamentit menaxhon njësinë bazë. Ndër detyrat e specifikuar: - përgatitja e programeve dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore - mbikqyrja e aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>- promovimi i praktikave më të mira të mësimdhënies - vlerësimi periodik të stafit</p> <p>Në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore, konstatohet se ka pedagogë të brendshëm të angazhuar në këtë program studimi me MSc. që japin leksione ndonëse janë asistent lektor. Për shembull MSc. V. L., është i angazhuar në dy lëndë dhe ka ngarkesë në auditor 445 orë, Msc. S. M., është i angazhuar në 4 lëndë ka ngarkesë në auditor 480.</p> <p>Në Rregulloren e programit bachelor, neni 10, është përcaktuar se viti akademik përbëhet nga dy semestra, me një kohëzgjatje normale prej 14 javësh për semestër mësim dhe dy javësh provime përfundimtare. Në nenin 11 të Rregullores të bachelorit, përcaktohet se kohëzgjatja maksimale e studimeve në programit bachelor është gjashtë vite.</p> <p>Në Rregullore është përcaktuar mënyra e organizimit të procesit mësimor, llojet e kurseve, kreditet, praktika profesionale dhe projekti i diplomimit.</p> <p>Në planin mësimor, është informacioni i detajuar për kurset, i ndarë në semestra, vite akademike, që përfshin llojin e veprimtarisë, nëse është kurs i detyrueshëm, orët në auditor, orët e studimit të pavarur, kreditet. Lëndët me zgjedhje që ofrohen në një vit akademik të caktuar, janë të detajuara.</p> <p>Konstatohet se, programi i studimit, Bachelor në Ekonomiks, është i organizuar në përputhje me objektivat e programit të studimit. Informacioni për programin e studimit është i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm dhe online në faqen e universitetit.</p> <p><i>Programi i studimit, ka angazhuar një numër të konsiderueshëm asistent lektorësh, për dhënien e leksioneve. Rekomandohet që dhënia e leksioneve të mbulohet nga staf akademik i kategorisë lektor.</i></p> <p>2. Statuti i Universitetit EPOKA 5. Rregullores të Universitetit EPOKA 7. Rregullore e studimeve Bachelor 13. Plani mësimor 71. Tabela përmbledhëse (tabela 4)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Neni 81 i Statutit, përcakton se viti akademik organizohet në dy semestra të rregullt me së paku 20 orë leksione, seminare e laboratorë në javë. Semestri i rregullt përfshin jo më pak se 14 javë kalendarike për zhvillimin e veprimtarive formuese.</p> <p>Në Rregulloren e studimit bachelor, është përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - viti akademik i ndarë në dy semestra me 14 javë mësimore - gjuha zyrtare e mësimdhënies, është gjuha angleze - numri i rediteve për semestër është 30 ECTS (60 ECTS për vit akademik) - Numri total i krediteve për programin e studimit 180 ECTS <p>Në planin mësimor, lëndët janë të ndara në semestra, vite akademike, duke</p>

	<p>specifikuar kategorinë, kreditet, ndarja e orëve në semestër, totali i orëve në auditor, totali i orëve jashtë auditorit. Janë të përcaktuara lëndët me zgjedhje që ofrohen në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve.</p> <p>Bazuar në nenin 41 të Rregullores së Universitetit, kushtet që duhet të plotësohen nga studentët me qëllim regjistrimin në një kurs, përcaktohen nga Departamenti i Ekonomiksit.</p> <p><i>7. Rregullore e studimeve Bachelor</i> <i>13. Plani mësimor</i> <i>2. Statuti i Universitetit EPOKA</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në nenin 84 të Statutit dhe në nenin 32 të Rregullores të Universitetit, çdo person që ka mbaruar maturën shtetërore, ka të drejtë të konkurojë për tu pranuar të ndjekë studimet në Universitetin EPOKA.</p> <p>Në nenin 37 të Rregullores të Universitetit, përcaktohet se kuotat e tansferimit përcaktohen nga Dekani i Fakultetit dhe miratohen nga Senati. Studentët e transferuar duhet të marrin të paktën 60 ECTS në Universitetin EPOKA, që të pajisen me diplomë.</p> <p>Tek Udhëzuesi për transferimet shpjegohet procedura e ndjekur. Bazuar në nenin 4, studentët që kërkojnë transferim duhet të plotësojnë një formular pranë Zyrës të Pranimit. Aplikimi shqyrtohet nga Departamenti dhe kalon tek Dekani i Fakultetit për miratim final. Transferimi mund të realizohet brenda Universitetit EPOKA, me kusht që studentët të kenë përfunduar të paktën një semestër në programin e tyre të studimit, dhe ndërmjet universiteteve.</p> <p>Procedurat e regjistrimit të studentëve janë të përcaktuara në Udhëzuesin për studentët. Në faqen zyrtare të institucionit, gjendet i gjithë informacioni i nevojshëm për pranimet dhe transferimet.</p> <p>Konstojnë se, pranimi i studentëve të rinj është në përputhje me nenin 74, të ligjit 80/2015 dhe me kriterit e notës mesatare, në përputhje me VKM 295 datë 10.05.2019.</p> <p>Pranimi për studentët e transferuar dhe njohja e krediteve është në përputhje me nenin 89, të ligjin 80/2015.</p> <p>Kriter shtesë për regjistrim në këtë program studimi janë: - Çertifikata e gjuhës angleze, niveli B1, nga TOEFL, IELTS, APTIS dhe çdo provim tjetër që parashikohet nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve - Nota mesatare mbi 7</p> <p><i>2. Statuti</i> <i>5. Rregullore e Universitetit Epoka</i> <i>9. Udhëzues për studentët</i> <i>51. Udhëzues për transferimin e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset)</p>	<p>Në planin mësimor, për secilën lëndë, është dhënë kategoria e lëndës, kreditet, ndarja e orëve në një javë (teori, praktikë, laborator, totali), orët e studimit gjatë gjithë semestrit (leksione, praktika, laborator, punë</p>




<p>për secilën lëndë për praktikën, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>individuale, të tjera dhe totali). Është përcaktuar, praktika mësimore në vitin e tretë të studimit semestri i parë, si lëndë me detyrim dhe projekti i diplomimit/ provim përfundimtar.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë janë përcaktuar orët e aktiviteve mësimore: teori, praktikë dhe laboratorë.</p> <p><i>Konstatohet se në syllabuset e lëndëve dhe planin mësimor nuk ka orë të përcaktuara praktike ose laborator, për asnjë nga lëndët që ofron programi i studimit, me përjashtim të praktikës profesionale që ka 6 orë në javë praktikë, me një ngarkesë totale 96 orë praktike dhe 25 orë punë individuale, dhe tezës të diplomimit/ provimit përfundimtar që ka të përcaktuar 4 orë praktikë në javë dhe 3 orë teori, me një ngarkesë prej 64 orë praktike dhe 48 orë leksioni, 30 orë punë individuale dhe 8 orë të tjera.</i></p> <p>5. Tabelat përbledhëse (tab. 10) 13. Plani mësimor 24- 29. Syllabus</p>		
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, Universiteti EPOKA ka hartuar politika për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, hyrë në fuqi datë 27.03.2018. Bazuar në vlerësimet të mbledhura për kurset e zhvilluara nga studentët aktual, alumni, institucione dhe biznese me të cilat ka bashkëpunime, identifikohen pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit. Në baza vjetore bëhet rishikimi i programit, që përfshin tregues të mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor, përgjegjshmërisë ndaj shoqërisë.</p> <p>Institucioni ka hartuar Manualin e sigurimit të cilësisë, në bashkëpunim me institucione të BE -së, si pjesë e programit Erasmus+ “Mbështetje strategjike për forcimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri”.</p> <p>12. Politika e Universitetit EPOKA për përmirësimin e programit 38. Manuali i sigurimit të cilësisë EPOKA</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Bachelor në Ekonomiks është i detajuar dhe strukturuar në funksion të objektivave të programit të studimit.</i></p> <p><i>Në këtë program studimi nuk ka orë laborator të përcaktuara në syllabus. Me përjashtim të praktikës profesionale dhe projektit të diplomimit, të gjitha lëndët kanë të përcaktuara vetëm orë leksioni.</i></p> <p><i>Programi i studimit, ka angazuar një numër të konsiderueshëm asistent lektorësh, për dhënien e leksioneve. Me kontretisht për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar 9 MSc. pedagogë të brendshëm dhe 5 MSc. pedagogë të jashtëm.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi II.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Në lëndët e ofruara në programin e studimit, konstatojmë se përmbushen objektivat e programit të studimit. Programi Bachelor në Ekonomiks, përfshin lëndët bazë mikroekonomi, makroekonomi, ekonometri në nivel të ndërmjetëm duke mundësuar thellimin e njohurive në nivelin Master. Në nivel mikroekonomik studentët përfitojnë njohuri për sjelljen dhe ndërveprimin e agentëve në treg, si për shembull shitësit, blerësit, familjet, firmat e biznesit.</p> <p>Në nivel makroekonomik studentët përfitojnë njohuri për modelet që përdoren për analizën e ekonomisë në tërësi, si në nivel kombëtar dhe global.</p> <p><i>Konstatojmë se disa lëndë që janë vendosur me zgjedhje, duhet të konsiderohen të jenë me detyrim si për shembull:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>“Historia e mendimit ekonomik”. Studentët duhet të kenë njohuri për zhvillimin historik të teorive ekonomike dhe metodave të kërkimit që përdoren sot. Duhet të njohin dhe të analizojnë kontributin e figurave kryesore si Adam Smith, John Keynes etj., dhe mënyrën sesi ngjarje të ndryshme historike kanë ndikuar në zhvillimin e teorive ekonomike. Nëse studentët nuk njohin të kaluarën, ata do ta kenë të vështirë të bëjnë analiza të sakta për të ardhmen si në nivel mikroekonomik dhe makroekonomik.</i> 2. <i>“Politika fiskale” dhe “Financat publike”, janë të dyja lëndë që ofrohen me zgjedhje. Mendojmë se “Financa publike” duket të jetë me detyrim, pasi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo analizon të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e qeverisë, borxhin publik. Konsolidimi fiskal është objektiv i çdo qeverie pas përkeqësimit të financave publike si pasojë e pandemisë Covid -19 dhe në të njëjtën kohë mbështetje e zhvillimit të qendrueshëm.</i> <p>Me njohuritë e përfituara në Bachelor, studentët mund të vazhdojnë studime të mëtejshme master, ose mund të futen në tregun e punës. Departamenti i Ekonomiksit, ofron master shkencor në Ekonomiks dhe Doktoraturë në Ekonomiks.</p> <p>13. <i>Plani mësimor</i> 18. <i>Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumnetacionit, konstatojmë se programi i studimit është i shpërndarë në tre vite akademike, me dy semestra secili vit, me një ngarkesë totale 180 ECTS, ku në çdo vit akademik dhe semestër ka një shpërndaje të barabartë të krediteve.</p> <p>Nga shqyrtimi i objektivave të programit të studimit dhe syllabuset e lëndeve konstatojmë se programi mundëson arritjen e objektivave.</p> <p>Studentët e profilit “Ekonomiks”, zhvillojnë aftësi dhe kompetanca në lidhje</p>

	<p>me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizën e të dhënave - lidhjet midis variablave të ndryshëm - përdorimin e programeve kopjuterike si STATA, SPSS - ndërtimin dhe prezantimin e argumenteve - vlerësimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve <p>18. Syllabuset</p>																		
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks, është i organizuar në orë leksioni dhe praktikë/laborator sipas strukturës më poshtë:</p> <p>Orë leksioni/ praktike</p> <table border="1" data-bbox="571 577 1391 696"> <thead> <tr> <th>Orë</th> <th>V.I</th> <th>V.II</th> <th>V.III</th> <th>Totali</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksion</td> <td>640</td> <td>640</td> <td>512</td> <td>1792</td> <td>91.8%</td> </tr> <tr> <td>Praktikë/laborator</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>160</td> <td>160</td> <td>8.20%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konstatohet se raporti teori -praktikë, për vitin e parë dhe të dytë të studimit është 100% teori dhe 0% praktikë. Vetëm në vitin e tretë të studimit, ka orë praktike të përcaktuara në syllabus dhe planin mësimor për praktikën profesionale dhe projektin e diplomimit. Për vitin e tretë raporti 76% teori dhe 24% praktikë.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Universitetit dhe në Statut, semestri i rregullt përfshin 14 javë kalendarike për zhvillimin e veprimtarive formuese dhe 2 javë provime. Në llogaritjen orëve në auditor për çdo lëndë të ofruar nga programi i studimit, numri i orëve në auditor për një javë mësimore shumëzohet me 16 javë, ndërkohë që vetëm 14 javë zhvillohen në auditor.</p> <p>Nga vizita në institucion, biseda me pedagogë të programit të studimit, konstatuam se ushtrimet/ praktikë zhvillohej në auditor por nuk e kishin të reflektuar në syllabus dhe në planin mësimor.</p> <p><i>Rekomandojmë, rritjen e orëve praktike në syllabus si dhe të konsiderohet llogaritja e ngarkesës në auditor, duke konsideruar javët për zhvillimin e veprimtarive formuese dhe jo provimet.</i></p> <p>2. Statuti 5. Rregullore e Universitetit EPOKA 13. Plani mësimor 18. Syllabuset 71. Tabelat përmbledhëse (tabela 10)</p>	Orë	V.I	V.II	V.III	Totali	%	Leksion	640	640	512	1792	91.8%	Praktikë/laborator	0	0	160	160	8.20%
Orë	V.I	V.II	V.III	Totali	%														
Leksion	640	640	512	1792	91.8%														
Praktikë/laborator	0	0	160	160	8.20%														
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaria formuese e programit të studimit, është në përputhje me tabelën 1, shtojca 1, e VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar.</p> <p>Konstatohet se, objektivat e përcaktuara në programin e studimit, mundësohen nga lëndët e ofruara. Studentët mund të konkurojnë në tregun e punës kombëtar dhe më gjërë, ata përfitojnë njohuri, që ju krijon atyre mundësi për të vazhduar studimet e ciklit të dytë.</p> <p>Praktika mësimore është përcaktuar në semestrin e pestë, si lëndë me vete, vlerësohet 5 ECTS, dhe ka të programuar 6 orë praktikë në javë.</p>																		




	<p><i>Konstatohet si pozitiv, faktin që praktika është programuar në semestrin e parë të vitit të tretë të studimit, pasi i krijon mundësi studentëve të vendosin kontakt me tregun e punës para se të përfundojnë studimet.</i></p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se institucione dhe kompanitë me të cilat bashkëpunohet për praktikën, janë të mjaftueshme për studentët e kursit, për të vënë në zbatim njohuritë e përfituara në auditor. Fakulteti ka memorandume bashkëpunimi aktive me 66 institucione publike dhe private. Vetëm për këtë program studimi, ka nënshkruar 6 marrëveshje. Praktika, i vë në kontakt studentët me kërkesat e punëdhënësve, për aftësi dhe kompetenca të caktuara, krijon mundësi për ballafaqimin e njohurive të përfituara në auditor me kërkesat e tregut të punës, mundëson krijimin e kontakteve për mundësi punësimi në të ardhmen.</p> <p><i>41. Marrëveshjet aktive të bashkëpunimit</i> <i>71. Tabelat përmbledhëse (tabela 5)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatohet se përditësimi i syllabusit, është pjesë e raportit vjetor të punës të Departamenti të Ekonomisë, për programin e studimit bachelor në Ekonomik. Departamenti promovon përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien, rritjen e përdorimit të platformave “JSTOR on line library”, Turnitin për kontrollin e plagjaturës, LMS (Moodle).</p> <p><i>Nga rishikimi i syllabuseve konstatohet se, si letaratura bazë ashtu dhe ajo plotësuese që përdoret në këtë program studimi është e viteve të fundit.</i></p> <p><i>18. Syllabus</i> <i>71. Tabelat përmbledhëse (tabela 17)</i> <i>89. Librat që janë shtuar që nga akreditimi i fundit</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga rishikimi i syllabuseve dhe planit mësimor, konstatohet se kurset e ofruara i pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend.</p> <p><i>Fakti që mësimdhënia është në gjuhën angleze, rritë mundësitë e studentëve për të punuar pranë kompanive të huaja që punojnë në vendin tonë, duke i bërë më konkurrues në tregun e punës.</i></p> <p><i>13. Plani mësimor</i> <i>18. Syllabus</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Diploma Bachelor në Ekonomik, jep mundësi për të ndjekur programet e ciklit të dytë të studimit. Studentët që kanë mbaruar këtë program studimi, kanë aftësi të bëjnë analiza të zhvillimeve ekonomike, të ndërtojnë modele të thjeshta dhe të bëjnë krahasime me zhvillimet ekonomike në vendet e tjera.</p> <p>Planifikimi i karrierës dhe Zyra alumni, organizojnë në mënyrë periodike pyetësorë për studentët e diplomuar, me qëllim që shikohet ecuria e tyre në tregun e punës, nëse aftësitë dhe kompetencat e fituara në universitet janë në përputhje me ato që kërkohen nga tregu i punës si dhe dëshirën e tyre për të vazhduar në programin e ciklit të dytë që ofron ky institucion.</p>




	<p>Institucionet me të cilat Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka memorandume bashkëpunimi, për realizimin e praktikave mësimore dhe mundësi punësimi për studentët, japin gjithashtu informacion në lidhje me ecurinë e studentëve në punë dhe aftësitë që ata kërkojnë.</p> <p>Departamenti i Ekonomiksit, në analizën e punës dhe raportin vjetor, merr në konsideratë mendimin e kompanive, institucioneve private dhe publike si dhe alumni për mërmirësim të mëtejshëm të kurikulës.</p> <p>14. Suplementi i diplomës 16. Alumni survey 41. Marrëveshje aktive bashkëpunimi 71. Tabelat përblëdhëse (tabela 5)</p>		
Konkluzione	<p>Rekomandojmë që raporti teori praktikë të rishikohet në të tre vitet e studimit bachelor, duke rritur peshën e orëve praktike në syllabus. Të rishikohet pesha e ngarkesës në auditor, në totalin e ngarkesës, pasi ajo aktualisht konsideron jo vetëm javët për zhvillimin e veprimtrive formuese por edhe provimet.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, është prioritet i Universitetit EPOKA. Rishikimi i kurikulës bëhet nga Departamenti i Ekonomiksit, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Komisioni për zhvillimin e kurikulës, Komisioni për sigurimin e cilësisë dhe nga Senati. Universiteti EPOKA ka mekanizma vlerësimi të kurseve dhe të mësimdhënies dhe mësimnxënies të cilat mbështeten në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorë për vlerësim e kursit nga studentët aktual - Vlerësim për mësimdhënien nga pedagogë të tjerë të fushës - Pyetësorë për kompani, institucione publike/private ku janë të punësuar studentë - Pyetësorë për alumni <p>Për çdo vit akademik, bëhet analiza e punës të Departamentit të Ekonomiksit. Në bazë të analizës përcaktohen pikat e dobta dhe mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p>Për këtë program studimi janë zhvilluar 27 aktivitete, nga Departamenti i Ekonomiksit me lektorë të ftuar nga kompani dhe institucione, me qëllim që të përfshijë studentët në diskutime për probleme reale dhe të rritë mundësitë për krijimin e kontakteve me tregun e punës.</p>


	<p>Mendimi i marrë nga pyetësorë për punën e studentëve, është shumë i rëndësishëm për Departamentin në përmirësimin e kurrikulës. Departamenti informohet për gadishmërinë e studentëve për të mësuar në vendin e punës, aftësitë e tyre organizuese, bashkëpunimin në punë me të tjerët etj.</p> <p><i>12. Politika e Universitetit Epoka për përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit</i> <i>16. Pyetësorë për Alumni</i> <i>45. Pyetësorë për ndërmarrjet</i> <i>20. Raporti vjetor i departamentit</i> <i>71. Tabela përmbledhëse, (tabela 19)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në vendim marrje në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues të studentëve (kryetari ose zëvendëskryetari i Këshillit të Studentëve), është përfaqësues në Senat, sipas përcaktimeve të nenit 15, pika 5 e Statutit të Universitetit - Këshilli i etikës ka përfaqësues student, sipas përcaktimeve të nenit 29, pika 4 e Statutit të Universitetit - Komisioni për marrdhëniet me studentët, ka dy përfaqësues të studentëve, sipas përcaktimeve të nenit 34, pika 2 e Statutit të Universitetit - Komisioni për sigurimin e cilësisë, sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 8 e Statutit, ka një përfaqësues të të diplomuarve të universitetit dhe zëvendëskryetari i Këshillit të Studentëve për çështjet e sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i komisionit. <p>Për çdo vit akademik, hartohen pyetësorë për studentë të diplomuar, me qëllim që të merret mendimi i tyre, për përmirësim të mëtejshëm të kursit.</p> <p><i>2. Statuti</i> <i>16. Pyetësorë për Alumni</i> <i>45. Pyetësorë për ndërmarrjet</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga Dokumentacioni i administruar, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka 66 marrëveshje aktive bashkëpunimi, të cilat shërbejnë jo vetëm për realizimin e praktikave mësimore dhe mundësi potenciale për punësimin e studentëve, por mendimi i tyre për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit merret me anë të pyetësorit të kompanive dhe është pjesë për rishikimin e kurrikulës në Departament.</p> <p>Për programin e studimit departamenti ka organizuar takime me përfaqësues të institucioneve publike/ private në kuadrin e aktiviteteve ekstrakurikulare.</p> <p>Forumi i palëve të interesit ka përfaqësues të stafit akademik, të firmave të biznesit, alumni, përfaqësues të dhomës së tregtisë, organizata joqeveritare. Forumi jep rekomandime për ndryshime të programit të studimit me qëllim rritjen e punësimin të studentëve të diplomuar.</p> <p><i>41. Marrveshje aktive bashkëpunimi</i> <i>75. Forum i palëve të interesit</i> <i>45. Pyetësorë për ndërmarrjet</i></p>

Konkluzione	<i>Universiteti EPOKA në përputhje me dispozitat e ligjit 80/2015, ka siguruar pjesëmarrjen e studentëve në vendmarrje. Shumë të rëndësishëm janë për institucionin alumni, të cilët ftohen në institucion për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët aktual.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Mënyrat e mësimdhënies janë të përcaktuara në Syllabusin e secilës lëndë në mënyrë të detajuar. Metodatat e mësimdhënies përfshijnë leksione, raste studimore, punë individuale dhe punë në grup, projekte, detyra dhe praktika profesionale.</p> <p>Në planin mësimor konstuam se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ka lëndë që për të njëjtën ngarkesë në auditor 3 orë teori në javë, ose 48 orë leksione në semester, vlerësohen me numër të ndryshëm kreditesh, pjesa më e madhe e tyre kanë 5 ECTS dhe disa lëndë të vitit të tretë kanë 6 ECTS. 2. Ka lëndë që kanë një ngarkesë të ndryshme në auditor dhe të njëjtën numër kreditesh. Për shembull 3 orë teori në javë, ose 48 orë leksion në semestër kanë 5 ECTS të njëjtën numër kreditesh me lëndë të cilat kanë një ngarkesë prej 4 orë teori në javë ose 64 orë leksion për semester, ka përseri 5 ECTS. <p>Kompensimi i orëve në auditor është bërë me orët jashtë auditorit, studim individual dhe të tjera.</p> <p>Konstatohet se kriteri ligjor i përcaktuar në pikën 2.1/b, VKM nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar, "një krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore pune studentit", plotësohet.</p> <p><i>Rekomandojmë që të rishikohen orët jashtë auditorit. Duhet të vendoset një korespondencë e drejtë midis ngarkesës në auditor dhe krediteve të lëndës.</i></p> <p>13. Plani mësimor</p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><i>18. Syllabuset</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se fusha e studimit dhe e specializimit e pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, përputhet me lëndët me të cilat ata japin mësim.</p> <p>Pedagogët janë të angazhuar dhe në kualifikimin e vazhdueshëm. Ata kanë përfshirë në mësimdhënie edhe teknologjinë duke përdorur platformat online, që mundësojnë materiale shtesë për kurset, si për shembull Jstore etj.</p> <p>Konstatohet së krahas formave të larmishme të mësimdhënies, kemi dhe përfshirjen e gjashtë studentëve, në proekte individuale të pedagogëve, që nga akreditimi i fundit.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion si dhe në faqen zyrtare të Universitetit EPOKA, konstatohet se ka një shumëllojshëri aktivitete që organizohen, si për të rritur cilësinë e mësimdhënies ashtu dhe për të pasuruar leksionet me raste studimore nga vendi dhe me gjerë. Ka lektorë të ftuar nga vendet e BE -së dhe nga institucione me të cilat Fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga aktivitetet e organizuara mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete dixhitale dhe inovative të mësimdhënies - Ballkani Përendimor në rrugën drejt antarësimit në BE - E ardhmja e të rinjve në Shqipëri - Përpunimi i të dhënave me programin R - Trajnim programi për sigurimin financiar <p><i>71. Tabelat përmbledhëse (tabela 22)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konstatohet se Universiteti EPOKA, organizon trajnime për stafin akademik, me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Për shembull në shtator 2018, është organizuar një trajnim për edukimin dixhital dhe zhvillimin e syllabusit. Në shtator 2023 është parashikuar workshop për zhvillimin e kurrikulës përmes rezultateve të të nxënësve dhe garatimi i cilësisë përmes rishikimit të literaturës.</p> <p>Në kuadër të programit të studimit janë organizuar katër leksione me lektorë të huaj të ftuar. Në total Departamenti ka organizuar 27 aktivitete për këtë program studimi. Pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar në mësimdhënie jashtë në kuadër të programit Erasmus +.</p> <p><i>35. Trajnim për edukim dixhital</i></p> <p><i>71. Tabelat përmbledhëse (tabela 19, 20)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p>	<p>Programi i studimit mbulohet kryesisht me pedagogë të brendshëm, të cilët japin mësim në lëndë në përputhje me kualifikimet dhe fushën e studimit të tyre. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie si dhe përditësimi i syllabusit në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend, integrimi i kërkimit shkencor me mësimdhënie, janë objektiva të vendosura në misionin e Universitetit EPOKA (neni 3), të cilat reflektohen dhe në këtë program studimi në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aktivitete të organizuar nga Departamenti në kuadrin e programit të studimit, përfshi dhe lektorë të huaj të ftuar




<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e stafit pedagogjik, për mësimdhënie në kuadër të programeve të shkëmbimi si Erasmus + - Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Bazuar në syllabuset e lëndëve, si dhe në të dhënat e pasqyruara në tabelën përmbledhëse 15, provimi përfundimtar për programin bachelor në Ekonomiks zë nga 25% deri në 60% të vlerësimit total. Projektet/ detyrat e kursit, punët në grup dhe individuale, aktivizimi gjatë orës së mësimit, nxit mendimin kritik dhe përgjegjshmërinë e studentëve. - Angazhimi i gjashtë studentëve në projekte individuale të pedagogëve të Departamentit (tabela 22) - Përshirja e praktikës profesionale, si lëndë më vete në vitin e tretë të studimeve, semestri i parë <p>2. Statuti 13. Plani mësimor 40. CV e personelit akademik 71. Tabela përmbledhëse (tabela 15, 22)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se Departamenti i Ekonomiksit, përgjegjës për programin e studimit, bën analizë vjetore të punës, e cila pasqyrohet në raportin vjetor të Departamentit. Bazuar në këtë analizë hartohen objektivat për vitin e ri akademik, si dhe planin e masave që duhet të merren me qëllim përbushjen e këtyre objektivave të vendosura.</p> <p>Për secilin vit akademik, bëhet vlerësimi i performancës individuale të pedagogëve, që japin mësim. Në këtë vlerësimim përfshihen disa rubrika që vlerësojnë njohuritë në lëndët të cilat pedagogu mbulon, materialet e kursit, metoda e mësimdhënies që përdoret, komunikimi që ka me studentët, kërkimi shkencor, botimet dhe kontributet akademike.</p> <p>NJSBC si pjesë e detyrave të saj funksionale, neni 8, pika 4, vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me standartet e vendosura të cilësisë. Për secilin semestër, shpërdahen pyetësorë vlerësimi për studentët. Pyetësori përban 14 pyetje, për të cilat studenti mund të zgjedh një alternativë të rankuar nga 4 në 0. Pyetësori përmban pyetje të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A janë të qarta objektivat e kursit në syllasus - A janë të përshtatshme metodat e mësimdhënies - A ka qenë i angazhuar dhe motivues profesori gjatë kursit - A janë ndihmuar nga profesori jashtë orëve të kursit - A ka qenë profesori i shqetësuar për progresin e studentëve <p>Për rezultatet e vlerësimit informohen pedagogët, pas përfundimit të semestrit dhe afishimit të notave, për lëndët respektive që ata janë të angazhuar, Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Ndaj problemeve të shfaqura, Drejtuesi i Departamentit ndërmer planin e veprimeve korrektuese.</p> <p>6. Rregullore e NJSBC 20. Raporti vjetor i departamentit</p>





	<p>26. Pyetësorë për studentët 86. Plani i veprimtarive parandaluese 76. Forma e vlerësimit të mësimdhënies</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në përmbushje të përcaktimeve të nenit 103, të ligjit 80/2015, Universiteti EPOKA ka ngritur njësinë për sigurimin e kontrollit të brendshëm. Bazuar në nenin 35, të Statutit të Universitetit EPOKA, Komisioni për Garantimin e Cilësisë, është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, për hartimin e standarteve të cilësisë bazuar në Kodin e Cilësisë që miratohet nga Senati akademik. Komisioni funksionon me rregullore të veçantë.</p> <p>Bazuar në nenin 5, të Rregullores së Komisionit për garantimin e Cilësisë, disa nga detyrat e kësaj njësie janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zhvillojë politika dhe procedura për garantimin e cilësisë të brendshme - të zhvillojë standarte për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë - të zhvillojë vlerësime periodike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor - të organizojë aktivitete trajnuese për zhvillimin profesional të stafit <p>Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhje.</p> <p>Bazuar në nenin 8, të Rregullores të Komisionit, janë tre njësi që varen nga Komisioni. (i) Zyra e garantimit të cilësisë, (ii) Komisioni për zhvillimin e kurikulës dhe (iii) Bordi i provimeve.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konstatohet se NJSBC, për përmbushjen e detyrave të saj organizon në mënyrë periodike pyetësorë për studentët për secilën lëndë në të gjitha programet e studimit dhe të dhënat e përfituara dërgohen në Departament dhe tek Dekani, sipas përcaktimeve të pikës 3 të ligjit 80/2015.</p> <p>Bordi i vlerësimit të performancës akademike dhe përmirësimit të cilësisë (ACAQIB), bazuar në nenin 8 të Direktivës, identifikon kriteret për matjen e performancës akademike dhe treguesit në përputhje me Planin Strategjik dhe objektivat e Universitetit. Bordi harton raporte një herë në dy vite akademike në bashkëpunim me NJSBC dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, bazuar në formularin e matjes dhe vlerësimit të performancës akademike.</p> <p>2. Statuti 6. Rregullore e Komisionit për garantimin e Cilësisë 8. Direktivë për vlerësimin e përmirësimit të cilësisë akademike dhe administrative 88. Formulari i matjes dhe vlerësimit të performancës akademike</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në programin e studimit përdoren metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë edhe teknologjinë me qëllim përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Sfafi akademik është kompetent dhe ka kualifikimet e nevojshme për lëndët që mbulon.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		




Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks, është e miratuar forma e kontrollit të njohurive, si më poshtë: (tabela 15, tabelat përmbledhëse)</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <tr> <td style="width: 60%;">Forma të kontrollit të njohurive</td> <td style="width: 40%;">Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">Përqindja në vlerësimin total</td> </tr> <tr> <td>Pjesmarrja dhe aktivizimi aktiv në kurs</td> <td style="text-align: center;">5-10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve(detyrave, eseve)</td> <td style="text-align: center;">10-30%</td> </tr> <tr> <td>Provim i pjesshëm</td> <td style="text-align: center;">20-45%</td> </tr> <tr> <td>Provim përfundimtar</td> <td style="text-align: center;">25-60%</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td style="text-align: center;">100%</td> </tr> </table> <p>Në syllabusin e çdo lënde është përcaktuar, metoda e vlerësimit të kursit, dhe pesha që zë secili komponent në vlerësimin e kursit. Nga shqyrtimi i syllabuseve, konstatohet se në disa lëndë nuk është përfshirë në vlerësim zëri pjesmarrje dhe aktivizim aktiv në kurs. Për shembull lënda “Ekonomiks ndërkombëtar II”, ka si pjesë të vlerësimit:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <tr> <td style="width: 60%;">Metoda</td> <td style="width: 40%;">Përqindja</td> </tr> <tr> <td>Provim i pjesshëm</td> <td style="text-align: center;">30%</td> </tr> <tr> <td>Rast studimi</td> <td style="text-align: center;">30%</td> </tr> <tr> <td>Provim përfundimtar</td> <td style="text-align: center;">40%</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">100%</td> </tr> </table> <p>Në të gjitha lëndët ka vlerësim të vazhueshëm gjatë vitit. Bazuar në nenin 5, të Statutut të Universitetit, EPOKA garanton lirinë akademike për të organizuar mësimdhënien. Bazuar në syllabus, frekuentimi i kursit është i detyrueshëm në masën 75%.</p> <p><i>2. Statuti</i> <i>18. Syllabuset</i> <i>71. Tabla përmbledhëse (tabla 15)</i></p>	Forma të kontrollit të njohurive	Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks		Përqindja në vlerësimin total	Pjesmarrja dhe aktivizimi aktiv në kurs	5-10%	Plotësimi i detyrimeve(detyrave, eseve)	10-30%	Provim i pjesshëm	20-45%	Provim përfundimtar	25-60%	Në total	100%	Metoda	Përqindja	Provim i pjesshëm	30%	Rast studimi	30%	Provim përfundimtar	40%		100%
Forma të kontrollit të njohurive	Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks																								
	Përqindja në vlerësimin total																								
Pjesmarrja dhe aktivizimi aktiv në kurs	5-10%																								
Plotësimi i detyrimeve(detyrave, eseve)	10-30%																								
Provim i pjesshëm	20-45%																								
Provim përfundimtar	25-60%																								
Në total	100%																								
Metoda	Përqindja																								
Provim i pjesshëm	30%																								
Rast studimi	30%																								
Provim përfundimtar	40%																								
	100%																								
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatuam se në fillim të çdo lënde, pedagogu përgjegjës informon studentët me detaje për lëndën duke vënë në dispozicion të tyre syllabusin. Forma e syllabusit, është në përputhje me shtojcën 2, të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar. Studentëve u bëhet e qartë forma e kontrollit të dijeve dhe frekuentimi. Studentët mund të ndjekin progresin e tyre akademik në platformën online të</p>																								




lëndës/modulit.	<p>ofruar nga Universiteti EPOKA, ku janë të hedhura mungesat, vlerësimet gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p><i>18. Syllabuset</i> <i>71. Tabla përblehëse (tabla 15)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në syllabuset, konstatojmë se testimi i njohurive është i bazuar në vlerësimin e vazhdueshmëm të njohurive të studentëve. Komponentë të vlerësimit të vazhdueshëm janë detyrat e shtëpisë, esetë, raste studimore, kuicet, punë në grup, pjesmarrje aktive gjatë kursit, provim i ndërmjetëm dhe provim përfundimtar.</p> <p>Pedagogët kanë mundësi në këtë mënyrë të ndjekin progresin e studentëve gjatë kursit dhe ti ndihmojnë për të kaluar vështirësi të hasura gjatë vitit.</p> <p>Nga vizita në institucion, konstatojmë se studentët takoheshin me profesorët për të diskutuar për paqartësi për kursin jo vetëm gjatë orëve të programuara mësimore.</p> <p><i>18. Syllabuset 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti me qëllim që të vlerësojë punën e pedagogëve, në funksion të cilësisë të mësimdhënies, përdorimit të literaturës të fundit, rasteve studimore, bazohet në vlerësimin e studentëve për pedagogët me anë të pyetësorëve duke marrë direkt mendimin e tyre. Pyetësorët shpërndahen për çdo lëndë para përfundimit të semestrit.</p> <p>Studentët pyeten në lidhje me kursin duke dhënë një vlerësim, në kufirin nga 4 shumë mirë në 0 shumë keq, për disa komponentë të kursit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - objektivat e kursit - materialet e kursit - njohuritë e përfituara nga kursi - metodat e mësimdhënies - përgatitjen e pedagogut - interesin e pedagogut për progresin e studentit - ndihmës nga ana e pedagogëve jashtë orëve të mësimi - zbatimit të orarit mësimor - mungesat e pedagogut gjatë kursit - përdorimit të librave dhe materialeve shtesë - drejtësinë në vlerësim - nëse e ka motivuar dhe angazhuar klasën <p>Departamenti përdor gjithashtu edhe formularë të vlerësimit të lëndës nga kolegë të të njëjtës fushë, të cilët caktohen nga Shefi i Departamentit dhe zhvillojnë vizitë në orën e mësimi. Nga vizita plotësohet një formular i cili është i strukturuar në disa komponentë, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerëson njohuritë e pedagogut në lidhje me kursin 2. Metodën e mësimdhënies 3. Komunikimin me studentët <p>Në këtë mënyrë, analizohen me detaje të gjitha aspektet e procesit të mësimdhënies dhe të angazhimit të pedagogëve gjatë orës së mësimi.</p> <p>Në përputhje me vlerësimet e marra nga studentët dhe nga pedagogë të tjerë të fushës, merren masa për përmirësimin e kursit në tërësi ose komponentëve</p>






	<p>që vlerësohen nën mesatare nga Shefi i Departamentit.</p> <p>26. Pyetësorë për student 76. Forma të vlerësimit nga kolegë</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Për çdo student është përcaktuar një pedagog këshilltar akademik, në përputhje me nenin 34 të Rregullores të Universitetit EPOKA. Ndër detyrat e këshilltarit akademik është monitorimi i progresit të studentit. Këshilltari akademik bashkëpunon me studentët dhe planifikon kurset që janë më të përshtatshme për ta gjatë semestrave vijues deri në diplomim.</p> <p>Universiteti EPOKA përdor platforma të ndryshme në funksion të mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Mund të përmendim platformën Moodle, Turnitin, EIS. Në funksion të mësimdhënies është libraria online, JSTOR, DSpace.</p> <p>Universiteti EPOKA, zhvillon trajnime për rritjen e cilësisë të mësimdhënies, për shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> - trajnim për zhvillimin e syllabusit me lektorë të huaj të ftuar. Trajnimi është zhvilluar në 26.09.2018 me pjesëmarrjen e Prof. Dr. Volker Gehmlich, Prof. Dr. Teoman Duman, Dr. Norma Ryan - trajnim i organizuar në 24.09.2018, nga zyra e burimeve njerëzore - trajnim i stafit të ri akademik në 27.09.2019 - trajnim për stafin akademik 16.10.2020 <p>Aktivitete të tjera si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konferencën e pestë ndërkombëtare të edukimit, të zhvilluar online në 23 janar 2021 - Përshpejtimi i Universiteteve të Ballkanit Përfundimor në modernizim dhe përfshirjen e teknologjisë virtuale. Takim i mbajtur në Universitetin EPOKA në 21.04.2021, në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian me nr. 610281-EPP-1-2019-AL-EPOKA2-CBHE-JP. <p>Me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore dhe botime, Universiteti EPOKA ka hartuar një direktivë me qëllim përcaktimin e metodave të inkurajimit të aktivitetit shkencor. Në nenin 4 të kësaj direktive përcaktohet se mbështeten vetëm autorët që botojnë në emrin e Universitetit EPOKA. Për çdo vit akademik madhësia e fondeve për kërkim shkencor miratohet nga Rektorati. Shpërblimi është në varësi të faktorit të impaktit të revistës.</p> <p>5. Rregullore e Universitetit Epoka 35. Aktivitete trajnimi 64. Direktivë për promovimin e botimeve shkencore 71. Tabelat përbledhëse (tabela 17)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga dokumentacioni i administruar dhe vizita në institucion, konstatohet se, testimi i njohurive bëhet përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Universiteti EPOKA ka investuar në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, ka hartuar procedurë për vlerësimin e cilësisë të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Kontrolli i njohurive bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit (tabela 15, tabelat përmbledhëse). Bazuar në të dhënat e kësaj table, konstatojmë se provimi përfundimtar zë nga 25% deri në 60% të vlerësimit, pjesmarrja aktive nga 5-10% të vlerësimit, detyrat e kursit nga 10-30% të vlerësimit dhe provimi i ndërmjetëm nga 20-45% të vlerësimit.</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde jepen në mënyrë të detajuar komponentet e vlerësimit që përdor secila lëndë, detyra klase, detyra shtëpie, ese, detyra kursi, punë në grup si dhe pesha e çdo komponenti në përputhje me lëndën duke respektuar liritë akademike.</p> <p>Univeriteti EPOKA, ka hartuar udhëzues për studentët, ku është përcaktuar se frekuentimi është i detyruar në masën 75%, si dhe sistemi i vlerësimit që përdoret për studentët e Bachelorit.</p> <p><i>9. Udhëzues për studentët</i> <i>18. Syllabuset</i> <i>71. Tabla përmbledhëse (tabla 15)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, konstatojmë se sisteme ekelektronike janë përdorur si gjatë fazës së mësimdhënies, ashtu edhe në vlerësimin e pjesshëm dhe përfundimtar të studentëve.</p> <p>Më konkretisht, platforma Turnitin ndihmon për të gjurmuar plagjaturën, përdoret si për detyrat e kursit ashtu edhe për tezën e diplomës. Studentët dhe pedagogët kanë akses në sistemin LMS i bazuar në Moodle, me qëllim që të organizojnë online materialet e kursit. Përdoret sistemi Koha, për të kërkuar libra online dhe për ti marrë ta përmes web. Google classroom është përdorur gjerësisht gjatë pandemisë.</p> <p>Sistemi EIS që përdor EPOKA, mbështet anonimitetin në procesin e provimeve. Sistemi gjeneron një kod për çdo student. Pedagogu merr listën e studentëve në provim me kode. Vetëm koordinatori i Departamentit është në dijeni të emrave të studentëve dhe kodeve respektive. Nga sistemi nota vendoset mbi kodin. Lektorit nuk është në dijeni të emrit të studentit. Vetëm në fund të semestrit, lektorit mund të shikoj notat për çdo student.</p> <p>Nga vizita në institucion, konstatojmë se sistemi EIS gjeneron një kod të ndryshëm për çdo student në secilin semestër.</p> <p><i>67. Shërbimet e teknologjisë dhe informacionit</i> <i>68. Ruajtja e anonimitet në provime</i> <i>71. Tabelat përmbledhëse (tabela 17)</i></p>




Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konkludojmë se zbatohen në mënyrë rigoroze, rregullat e kalimit të kursit dhe sistemi i vlerësimit, i pasqyruar në nenin 17 dhe 20 të Rregullores të Universitetit EPOKA për programin bachelor.

Në vlerësim përfundimtar përfshihen të gjithë komponentët e vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit. Vlerësimi bëhet duke përdorur sistemin interaktiv EIS. Studenti duhet të ketë frekuentuar kursin të paktën 75%. Vlerësimi bëhet bazuar në tabelën e mëposhtme:

Nota shkronjë	Koeficienti	Pikët	Nota
AA	4.00	90-100	10
BA	3.50	85-89	9
BB	3.00	80-84	8
CB	2.50	75-79	8
CC	2.00	70-74	7
DC	1.50	65-69	6
DD	1.00	60-64	5
FD	0.50	50-59	4
FF	0.00	0-49	0

Bazuar në nenin 18, të Rregullores, studentët që e kalojnë kursin me CC konsiderohen të suksesshëm. Një student që merr FD ose FF për kurset e detyruara, nuk konsiderohet i suksesshëm dhe duhet të përsërisë kursin. Një student që merr FD dhe FF për lëndët me zgjedhje nuk është i detyruar të frekuentojë të njëjtin kurs.

Studentët me GPA 2.00 ose me lartë që nuk kanë notë FD ose FF janë konsideruar të suksesshëm.

7. Rregullore e Universitetit Epoka për programin bachelor

Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.


Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni, konstatojmë se:

- Studentët kanë në dispozicion kalendrin akademik, në të cilin janë të përcaktuara periudhat e regjistrimit, provimi i ndërmjetëm, provimi përfundimtar.
- Univeriteti EPOKA përdor turnitin për kontrollin për plagjaturë të punëve individuale të studentëve dhe për temën e diplomës.
- Komunikimi i vlerësimit i detajuar, bëhet online me anë të platformës interaktive EIS, duke ruajtur diskrecionin e vlerësimit të çdo studenti. Studenti informohet në këtë platformë për mungesat, detyrat e shtëpisë, esetë etj., vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, vlerësimin përfundimtar. Platforma është interaktive duke krijuar mundësi për vendosjen e komenteve për detyra të realizuara në kuadër të kursit.

Forma e vlerësimit të provimit nga ekspertë përmban disa kritere të vlerësimit, si:

- a është i dizenuar programi në përputhje me objektivat e kursit
- a është i ndërtur mbi materialet e përdorura gjatë kursit
- nëse pyetjet janë të formuluar qartë
- nëse kriteret e vlerësimit janë formular qartë
- numri i pyetjeve


	<ul style="list-style-type: none"> - përqindja që zë provimi në përputhje me syllabusin - nëse pedagogu ka evidentuar gabimet në fletën e provimit - përqindja e studentëve që është përgjigjur të gjithë pyetjeve <p>Universiteti EPOKA ka nxjerr udhëzime për realizimin e provimeve, si pjesë e detyrave të Bordit të provimeve. Bordi i provimeve, siguron cilësinë e vlerësimit. Bordi i provimeve e zhvillon aktivitetin e tij nën Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Ndër detyrat e bordit të provimeve, sipas nenit 4, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendos udhëzime për organizimin e provimit të pjeshëm dhe përfundimtar - monitoron nëse zbatohen rregullat gjatë zhvillimit të provimit - monitoron cilësinë e testeve dhe provimeve - bën statistika të vlerësimeve për çdo semestër <p><i>36. Direktiva të funksionimit të bordit të provimeve</i> <i>37. Udhëzime për provimet</i> <i>74. Forma e vlerësimit të provimit nga ekspertë</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha detyrat që përbëjnë vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, përfshi dhe temën e diplomës hidhen on line në platformën Tuniting dhe bëhet verifikimi për plagjaturë. Në nenin 5 të kodit të sjelljes të studentit, përcaktohet se merren masa disiplinore ndaj plagjaturës, kopimit ose lejimit të kopimit në provime. Në përputhje me nenin 8, të Kodit të Sjelljes, studentët mund të pezullohen një ose dy semestra, për këtë shkelje. - Mbikqytësit e provimeve janë anëtarë të stafit akademik që caktohen me propozim të Departamentit. - Pedagogët duhet të sigurohen që fletët e provimit janë të plota dhe të kanë të vendosur kodin e provimit - Korigjimi i provimeve bëhet me kod - Vlerësimet hidhen online në sistemin interaktiv EIS të Universitetit EPOKA - Vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, pedagogu mund të shikojë vlerësimin për çdo student <p><i>37. Udhëzime për provimet</i> <i>53. Kodi i sjelljes së studentëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve, shpallen brenda pesë ditëve nga data e dhënies së provimit pasi, studentët e bachelorit që janë vlerësuar me notat të ulta DC, DD, FF dhe U, në përputhje me nenin 23, të Rregullores së Universitetit për programin Bachelor, kanë të drejtë të japin provim shtesë, një javë pas përfundimit të provimit përfundimtar.</p> <p>Vlerësimet merren online nga studentët në sistemin EIS. Në sistem janë të hedhura të gjithë komponentët e vlerësimit në përputhje me syllabusin e lëndës, si dhe mungesat e studentit gjatë kursit.</p> <p>Bazuar në nenin 47, të Rregullores bazë të Universitetit EPOKA, vlerësimi i studentëve i dorëzohet në Departament brenda periudhës të përcaktuar në kalendarin akademik.</p>




	<p>5. Rregullores bazë të Universitetit EPOKA 7. Rregullore e Universitetit EPOKA për bachelorin dhe provimet</p>		
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, konstatojmë se e drejta e studentëve për të ankimuar vlerësimin është respektuar.</p> <p>Në nenin 51, të Rregullores bazë të Universitetit EPOKA, si dhe në nenin 25 të Rregullores për programin bachelor, përcaktohet që studentët kanë të drejtë të paraqesin një ankesë me shkrim në Zyrën e Regjistrimit brenda pesë ditëve nga shpallja e rezultateve të provimit. Ankesa vlerësohet nga pedagogu i lëndës në lidhje me gabimet materiale dhe aplikimi finalizohet nga Dekanati i Fakultetit bazuar në propozimin e Departamentit që e ofron kursin.</p> <p>Universiteti EPOKA, ka hartuar një formular standart, që plotësohet nga studentët, për ankimimin e notës. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë rezultatet e provimit të ndërmjetëm dhe ato të provimit përfundimtar.</p> <p>Në formular janë të përcaktuara disa arsye për ankimim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gabim matematikor - Nota nuk reflekton performacën gjatë kursit - Nota nuk reflekton kërkesat e përcaktuara në syllabus - Arsye të tjera <p>Bordi i provimeve i ngritur për të garantuar cilësinë e provimeve, ndjek procedurën formale të kundërshtimit të vlerësimit.</p> <p>5. Rregullores bazë të Universitetit EPOKA 7. Rregullore e Universitetit EPOKA për bachelorin dhe provimet 36. Bordi i provimeve 54. Procedura e ankimimit të notes</p>		
Konkluzione	<p><i>Kriteri ligjor përmbushet plotësisht nga institucioni. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, bën që pedagogët të njohin aftësitë dhe shikojnë progresin e studentit gjatë kursit. Përdorimi i platformës kundër plagjaturës, garanton drejtësi në vlerësimin e punëve të studentëve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	N	P	X

<p>Standardi 3.1.4 Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Bazuar në vizionin dhe misionin e Departamentit të Ekonomiksit, studentët në këtë program studimi përgatiten me njohuri të përgjithshme në përputhje me sfidat e ekonomisë, zhvillojnë të menduarin kritik, aftësi kërkimore, aftësi të forta statistikore, aftësohen për të ndërtuar dhe prezantuar argumenta, për t'u angazhuar në debate publike në lidhje me çështjet ekonomike.</p> <p>Në programin e studimit, studentët gërshetojnë njohuri të përfituara në lëndë si matematika, statistika, ekonometria etj., për të ndërtuar parashikime ekonomike, duke zhvilluar aftësi analitike që i bën më konkurrues në tregun e punës.</p>

	<p>4. Plani strategjik i Departamentit të Ekonomiksit 13. Programi mësimor 20. Raporti vjetor i Departamentit</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit ofron me zgjedhje lëndën “Menaxhimi i sistemeve të informacionit”, që njeh studentët me konceptet bazë të sistemeve të informacionit dhe rolin e tyre në një organizatë biznesi. Lënda me detyrim “Parimet e programimit”, i përgati studentët me konceptet bazë të programimit dhe përdorimin e programit Python. “Interneti dhe marketingu në rrjetet sociale”, ”E -Marketing” lëndë me zgjedhje, me qëllim që studentët të zhvillojnë komunikim interaktiv me klientët.</p> <p>Lëndët “Statistikë I” dhe “Statistikë II”, të cilit rrisin aftësinë e studentëve për të bërë analiza të thjeshta të dhënash, të krijojnë dhe ruajnë baza të dhënash dhe të njohin programe specifike si SPSS që mundësohen në kuadrin e këtyre lëndëve.</p> <p>Lënda “Ekonometri I”, mundëson që studentët të ndërtojnë regresione për variabla të interesit dhe të analizojnë ecurinë e tyre në kohë, duke rritur aftësitë e tyre përpunuese të të dhënave. Lënda ka aplikance të programeve për përpunimin e të dhënave si STATA.</p> <p>Në programin e studimit ofrohen si lëndë me detyrim “Anglisht Biznesi”. Kursi synon që të zhvillojë aftësitë e studentëve për të sintetizuar dhe vlerësuar informacionin dhe të zhvillojnë kërkim të pavarur bazë. Programi ofron si lëndë me zgjedhje disa gjuhë të huaja që synojnë që të zhvillojnë aftësitë e studentëve për të lexuar, shkruar dhe komunikuar në këto gjuhë, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Turqisht niveli I, niveli II - Gjermanisht niveli I, niveli II - Frëngjisht niveli I, niveli II - Italisht niveli I, niveli II <p>13. Programi mësimor 18. Syllabuset</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Në raportin vjetor të punës të Departamentit të Ekonomiksit, bëhet një analizë e detajuar e punës si në lidhje me mësimdhënien ashtu dhe me kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në kërkimin shkencor. Analizohen aspekte të ndryshme si kalueshmëria, nota mesatare, materialet e përdorura në mësimdhënie, përfshirja e ekspertëve vendas për konkretizim me raste studimore nga vendi, në kuadër të lëndëve të veçanta të programit. NJSBC shpërndan pyetësorë në çdo semestër që plotësohen për të gjitha lëndët nga studentët, rezultatet i kalojnë drejtuesit të departamentit dhe pedagogut të lëndës.</p> <p>Bordi i provimit, është njësi përgjegjëse për cilësinë e provimeve, e cila harton rregullore dhe miraton standarte vlerësimi. Kjo njësi harton raport në bashkëpunim dhe me njësi të tjera, të cilët kalojnë në Departament dhe Dekanat.</p> <p>Institucioni zbaton forma të vlerësimit të provimit nga ekspertë, të cilat vlerësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse aktivitetet e zhvilluara gjatë kursit janë në përputhje me ato të miratuara në Syllabus




	<ul style="list-style-type: none"> - Nëse niveli i testeve është në nivelin e kursit - Nëse testet kanë arritur qëllimin, objektivat e kursit - Nëse vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë - Nëse notat e vendosura janë në përputhje me sistemin e pikëzimit të miratuar - Nëse formati përfundimtar i vlerësimit, reflekton ose jo peshën e komponentëve të ndryshëm të syllabusit <p>18. Syllabuset 20. Raporti vjetor i Departamentit 36. Direktiva për funksionimin e bordit të provimeve 74. Forma e vlerësimit të provimit nga ekspertë</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV të stafit akademik, konstatojmë se lënda që ata mbulojnë në këtë program studimi përputhet me shkollimin e tyre dhe fushën e tyre të kërkimit dhe ekspertizës.</p> <p>Bazuar në vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, ku i është dhënë një peshë prej 10%, personeli akademik nxit pjesëmarrjen aktive gjatë orës së mësimi duke zhvilluar punë në grup, raste studimore, prezantim detyrash etj.</p> <p>Departamenti ka organizuar në kuadër të programit të studimit leksione me lektorë të huaj të ftuar.</p> <p>Si pedagogët ashtu edhe studentët janë të angazhuar në programin Erasmus të shkëmbimit. Nga programi i studimit, 11 studentët janë angazhuar në programet Erasmus + të shkëmbimit. Pedagogët e departamentit janë të angazhuar në mësimdhënie jashtë vendit.</p> <p>Për periudhën në analizë, pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar në tetë konferenca ndërkombëtare jashtë vendit. Nga vizita në institucion kontaktuar se ata, përdorin pjesë të kërkimit të tyre shkencor në mësimdhënie, duke rritur rastet studimore ilustruese të temave.</p> <p>Universiteti EPOKA ka zhvilluar një sërë trajnimesh për pedagogët e rinj, për përdorimin e teknologjisë, me qëllim rritjen e cilësisë të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjisë.</p> <p>Pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar si partnerë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>35. Dokument për trajnime të zhvilluara 71. Tabela përmbledhëse (tabela 20)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dorëzuara nga institucioni, personeli akademik me kohë të plotë i Departamentit të Ekonomiksit nga viti akademik 2017-2018 dhe në vijim, ka realizuar botime shkencore, ka marrë pjesë në 4 projekte të financuara nga jashtë (IDEA, VALEU-X, SUCCESS, COWEB), 8 COST action, ka realizuar pesë projekte kërkimi me fonde të brendshme. Departamenti ka zhvilluar 4 orë mësimore me lektorë të huaj dhe, ka realizuar 8 prezantime në konferenca ndërkombëtare.</p> <p>GVJ konstaton se nuk ka dokumentacion mbështetës për projektet IDEA, VALEU-X, SUCCESS të cilat nuk gjenden as në web të Universitetit.</p> <p>25. Konferenca ndërkombëtare dhe botime 71. Tabla përmbledhëse (tabela 19, 20)</p>




Konkluzione	<i>Konstatohet se, programi i studimit bachelor në Ekonomiks, i ka kushtuar rëndësi të veçantë formimit të njohurive analitike të studentëve, aftësi të kërkimore, vlerësimin kritik, duke i bërë ata më konkurrues në treg</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Ligji 80/2015, në nenin 73, pika 2, përcakton “Studentët e programit të ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose diplomë.” Konstatohet se të dyja këto forma zbatohen në programin bachelor në Ekonomiks.</p> <p>Në nenin 16, të Rregullores të programit bachelor, është përcaktuar që në fund të semestrit të pestë, studentët me mesatare CGPA më pak se 3.00 nga 4.00 duhet të zhvillojnë provim përfundimtar, ndërsa studentët me CGPA më shumë se 3.00 mund të zgjedhin të marrin një projekt diplomimi ose të zhvillojnë provim përfundimtar.</p> <p>Në nenin 29, të Rregullores të programit bachelor, janë përcaktuar kushtet e diplomimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studenti duhet të ketë mbyllur me sukses të gjitha kurset e programit akademik dhe të ketë të paktën CGPA 2.00, pa vlerësime FD dhe FF, konsiderohet që ka plotësuar kriteret për diplomim - Studentë që janë në fazën e diplomimit që kanë nota FD ose FF në maksimumi dy kurse ose CGPA poshtë 2.00 pavarësisht se nuk kanë lëndë të mbetur, kanë të drejtë të zhvillojnë provime shtesë. Provimet shtesë jepen për kurset që janë vlerësuar me notën F, FD, DD dhe DC në fund të semestrit respektiv. Studentët lejohen që për të plotësuar kërkesat e diplomimit, të ushtrojnë të drejtën e provimit shtesë maksimumi tre herë gjatë periudhës të diplomimit. - Studentët që kanë mbyllur me sukses kurset dhe kanë akumuluar 180 ECTS përfitojnë diplomë Bachelor. <p>Krahas specifikimeve të dhëna në Rregulloren e programit Bachelor, tek Udhësuesi për studentët janë gjithashtu të shpjeguara kriteret e diplomit. Të gjitha Rregulloret e Universitetit EPOKA, si dhe udhëzuesi për studentët gjenden online në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>7. Rregullore e Universitetit Epoka për programin Bachelor 9. Udhëzuesi për studentët</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe</p>	<p>Provimi përfundimtar, është kurs i rregullt lëndë me detyrim që ofrohet në programin e studimit Bachelor. Provimi përfundimtar, në përputhje me syllabusin përfshin 50 pyetje të marra nga një bashkësi prej 450 pyetjesh me të cilat studentet merren gjatë kursit. Provimi vlerësohet me notë nga FF deri</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>në AA në përputhje me rezultatet. Nota kaluese është DD, si në të gjithë kurset e tjera.</p> <p>Projekti i diplomimit është kurs i rregullt lëndë me detyrim që ofrohet në programin e studimit Bachelor. Projekti i diplomimit është një punë individuale, e cila demonstroi aftësitë analitike dhe njohuritë teorike të përfituara nga studenti. Studenti këshillohet nga një supervizor që duhet të shkruajë raporte progresi gjatë gjithë semestrit për punën, në mënyrë që problemet specifike të aspekte të ndryshme të temës të diskutohen. Supervizori i projektit, e udhëzon dhe ndihmon studentin për të realizuar temën e zgjedhur në lidhje me rishikimin e literaturës, pyetjet kërkimore, metoda e kërkimit, testimi i hipotezave.</p> <p>Projekti i diplomimit kalon kontrollin e plagjaturës me programin Turnitin. Universiteti EPOKA, ka hartuar udhësues projektin e diplomimit, e cila është në dispozicion të studentëve. Udhëzuesi lehtëson punën e shkruajtjes të projektit, tërheq vëmendjen për citimet në tekst, burimin e të dhënave, literaturën, si dhe kontrollin për plagjaturë. Në udhëzues jepet një strukturë e temës që duhet të ndiqet nga studentët.</p> <p>Sudentët gjatë ciklit Bachelor ndjekin kursin me detyrim “Zhvillimi i aftësive të lexuarit dhe të shkruarit”. Kursi, zhvillon aftësitë teorike dhe konceptuale të studentëve për të punuar me gjuhën akademike angleze dhe përmban detyra praktike për zhvillimin e këtyre aftësive. Kursi lehtëson punën individuale të diplomës për të plotësuar standartet e kërkuara.</p> <p><i>5. Rregullore bazë e Universitetit Epoka</i> <i>18. Syllabuset</i> <i>70. Udhëzues për të shkruajtur projektin e diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në nenin 16, të Rregullores për programin Bachelor, Departamenti është përgjegjës për organizimin e provimit përfundimtar dhe projektin e diplomimit.</p> <p>Bazuar në nenin 24, gërma b, të Rregullores për programin Bachelor, provimi drejtohet nga pedagogu i kursit.</p> <p>Si provimi përmbyllës ashtu edhe projekti i diplomimit, janë regjistruar si kurse të rregullta me detyrim në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion, konstatuam se diploma mbrohet para një komisioni me 3 pedagogë. Vlerësimi i pedagogut drejtues, konsiderohet nga komisioni për dhënien e vlerësimit përfundimtar.</p> <p><i>7. Rregullore e Universitetit Epoka për programin Bachelor</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Bachelor, projekti i diplomimit ndiqet nga supervizori akademik gjatë gjithë semestrit, duke hartuar progres raporte në lidhje me punën e realizuar. Vlerësimi i supervizorit konsiderohet nga juria për mbrojtjen e temës të diplomës në dhënien e vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Projekti i diplomimit dhe provimi përfundimtar, regjistrohet si lëndë me detyrim, në semestrin e II, viti i tretë i studimeve dhe, kanë një syllabus të</p>

<p>miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>miratuar. Kurset kanë të parashikuar 3 orë teori dhe 4 orë praktikë në javë, me një ngarkesë semestrale prej 48 orë leksionesh dhe 64 orë praktike. Studentët që kanë detyrim përmbyllës projekt diplomimi bëjnë konsulta me supervizorin. Kursi është orjentues në lidhje me kërkesat e shkrimit të projektit të diplomimit. Supervizorit i inkurajimi i studentëve të shqyrtojnë literaturën e përshtatshme, të aplikojnë metodologjinë e përshtatshme bazuar në literaturë, ofron mbështetje të përgjithshme dhe, udhëzime gjatë gjithë procesit.</p> <p><i>7. Rregullore e Universitetit Epoka për programin Bachelor</i> <i>18. Syllabuset</i> <i>70. Udhëzues për të shkruajtur projektin e diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në funksion të realizimit të projektit të diplomimit, është biblioteka on line. Burim i hapur për pedagogët dhe studentët janë sistemet Koha, DSpace, libraria online JSTOR. Për kontrollin e plagjaturës është platforma online Turitin.</p> <p>Në varësi të temës, pedagogu udhëheqës asiston për hartimin e pyetësorëve për studime specifike të tregut. Për përpunimin e të dhënëve shfrytëzohen programet që janë vënë në dispozicion nga programi i studimit të tilla si SPSS, Stata, etj.</p> <p><i>7. Rregullore e Universitetit EPOKA për programin Bachelor</i> <i>71. Tabla përmbljedhëse (tabela 17)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konstatojmë se mënyra e vlerësimit për provimin përfundimtar dhe projektin e diplomimit është e njëjtë me vlerësimin që bëhet në të gjitha lëndët e tjera të programit të studimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të Rregullores të Programit Bachelor.</p> <p>Vlerësimi është notë e shprehur në shkronjë. Studenti konsiderohet në provë për notën 5(pesë) ose DD, nga 60-64 pikë dhe CGPA 1.00 si dhe notën 6(gjashtë) ose DC, CGPA 1.5, nga 65-69 pikë. Studenti konsiderohet i suksesshëm me vlerësimin 7(shtatë) ose CC, CGPA 2.00, ose nga 70-74 pikë. Vlerësimi maksimal është nota 10(dhjetë) ose AA, përqindja e pikëve 90-100, dhe CGPA 4.00.</p> <p><i>7. Rregullore e Universitetit EPOKA për programin Bachelor</i> <i>18. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në nenin 29, të Rregullores të programit të studimit bachelor, studentët që kanë fituar 180 ECTS, kanë CGPA të paktën 2.0, nuk kanë vlerësime FD ose FF, përbushin kërkesat për diplomim dhe pajisen me diplomë të ciklin bachelor. Diploma lëshohet e nënshkruar nga Dekani dhe Rektori.</p> <p>Lëshimi i diplomës dhe suplementit të diplomës është në përputhje me përcaktimet e nenit 91, të ligjit 80/2015. Studenti ka përfunduar me sukses studimet bachelor në Ekonomiks pajiset</p>




		me një diplomë dy gjuhëshe (anglisht dhe shqip) me emërtim Bachelor në Ekonomiks. Në diplomë është sistemi i vlerësimit i aplikuar nga Universiteti Epoka dhe të gjitha kërkesat sipas përcaktimeve të ligjit. <i>5. Rregullore bazë e Universitetit EPOKA</i> <i>7. Rregullore e Universitetit EPOKA për programin Bachelor</i> <i>14. Modeli i Diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.		Progresi i vazhdueshëm i studentit, hidhet online në sistemin interaktiv EIS, në përfundim të provimeve procesverbalët dorëzohen në Departament. Procedura e lëshimit të diplomës përfshin dhe fazën e arkivimit. Procesi i arkivimit të diplomës, listës zyrtare të notave dhe shtojcës së diplomës të diplomuarve është parashikuar në rregulloren e arkivës të Universitetit EPOKA. Kopje elektronike dhe të stampuara të diplomave dhe shtojcave të diplomave ruhen gjithashtu në arkivën e rektoratit, ndërsa të dhënat elektronike të të gjithë listë notave mbahen nga zyra e regjistratit. Sipas ligjit të arsimit të lartë nuk lëshohet dublikatë diplome. Kopje elektronike e tyre ruhet në një vend tjetër përveç sekretarisë mësimore. Pranë sekretarisë mësimore mirëmbahen dhe ruhen në mënyrë të përhershme Regjistrat Themeltar (Amzat), Regjistrat e arritjeve akademike dhe Regjistrat e lëshimit të diplomave dhe vërtetimeve. https://registrar.epoka.edu.al/kat-rregullat-rregullorja-505.html . Rregullore për zyrën e regjistrimit
Konkluzione		<i>Konstatohet se institucioni, zbaton një procedurë të qartë për detyrimet përfundimtare, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht X
---	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në	Struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Universitetin Epoka është Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo strukturë është përgjegjëse për të mbledhur dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat në lidhje me rekrutimin e stafit të ri të të gjitha kategorive, për të përditësuar dokumentacionin e stafit ekzistues dhe për të ndjekur procedurat ligjore për marrëdhënien kontraktuale të tyre me institucionin. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet në dy mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • me një dosje personale fizike në Zyrën e Burimeve Njerëzore <p>Dosja e personelit akademik përditësohet një herë në vit me dëshmitë e titujve/gradave, trajnimet dhe CV.</p> <ul style="list-style-type: none"> • me një dosje elektronike <p>Ndërsa të dhënat që lidhen me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore të stafit akademik mblidhen, përpunohen dhe raportohen nga departamenti.</p> <p>Drejtuksi i departamentit mbikëqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësisë bazë. Për të gjithë personelin akademik përcaktohet ngarkesa vjetore e shpërndarë në dy semestra dhe sipas veprimtarive mësimore. Ngarkesa mësimore shpërndahet sipas nevojave të Departamentit dhe shënohet në kontratën individuale të secilit. Zyra e Burimeve Njerëzore nuk ka informacion mbi ndarjen e ngarkesës së stafit akademik.</p> <p>Kontratat e punës hartohen në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në RSH" dhe Kodin e Punës. Kontratat për stafin akademik lidhen me Rektorin e Universitetit, për stafin ndihmës akademik me Administratorin. [neni 4, shtojcë 11]</p> <p><i>2. Statuti i Universitetit Epoka</i> <i>11. Rregullore e brendshme e Universitetit Epoka "Për rekrutimin e stafit"</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Rekrutimi i të gjitha kategorive të personelit akademik rregullohet nga Dokumenti I Rregullores së Brendshme të Universitetit Epoka [shtojcë 52 Mbi direktivat e ngarkesës mësimore]. Në këtë proces një rol të rëndësishëm kanë Njësia Bazë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Sipas nenit 2 të kësaj rregullore ngarkesa e stafit akademik është e përcaktuar në kontratën e secilit anëtar. Mbështetur në këtë rregullore, orët e provimeve finale dhe provimeve të ndërmjetme konsiderohen në ngarkesën mësimore. Bazuar në shtojcë 71; tabela përmblylëse, Tabela 4 "Mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi", vihet re një shpërndarje jo e barabartë e ngarkesës mësimore. Ngarkesa mësimore varet nga nevojat e departamentit dhe përcaktohet në kontratën e punës së cdo individi.</p> <p><i>52 Mbi direktivat e ngarkesës mësimore</i> <i>71. Tabela përmblylëse [Tabela 4]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin</p>	<p>Departamenti I Ekonomiksit që mbulon këtë program studimi, përmbush kriteret ligjore të ligjit nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencore në RSH". Departamenti përbëhet nga 7 anëtarë PAE dhe 0 PAK në vitin aktual akademik. Ky numër nuk ka ndryshuar që nga viti akademik 2018-2019, por përbërja e departamentit ka ndryshim [shtojcë 71, tabela përmbledhëse, 2-3]</p> <p>Për realizimin me sukses të procesit mësimor, angazhohen anëtarë nga</p>





<p>me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>departamentet e tjera të universitetit. Në shtojcë 40 (430 faqe) jepen CV e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi. CV nuk janë të përditësuara dhe janë në modele të ndryshme. Përfshirja e stafit ndër vite dhe mos përditësimi I CV, e bën të vështirë evidentimin e tyre.</p> <p><i>40. CV e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit nga akreditimi i fundit</i> <i>71. Tabela përmblylëse [Tabela 2-3]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi I stafit mbështetet në Rregulloren e Universitetit Epoka “ Mbi rekrutimin e stafit”. Gjithashtu për rekrutimin e stafit, Universiteti Epoka mbështetet në ligjin nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencore në RSH" si dhe në Statutin e Universitetit dhe Kodin e Punës së RSH.</p> <p>Departamenti dhe njësia kryesore shpall kriteret për pozicionin vacant, dhe pas miratimit nga Bordi Administrativ, Departamenti dërgon kërkesën për nisjen e procedurës së rekrutimit tek Zyra e Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore nis procesin me shpalljen e vendit vacant (koha e aplikimit është minimalisht 15 ditë) dhe pranimin e aplikimeve.</p> <p>Aplikimet shqyrtohen nga Komisioni Shkencor I Njësisë Bazë. Aplikantët merren në intervistë dhe ata që kalojnë këtë fazë ftohen të japin dhe leksione te hapura.</p> <p>Institucioni nuk ka kritere specifike për të garantuar marrjen në punë të aplikantëve më cilësor; psh mesatare e lartë.</p> <p>Pas shpalljes fitues, institucioni lidh kontratat e punës ku specifikohet dhe ngarkesa mësimore. Ngarkesa mësimore është e ndryshme sipas nevojave të institucionit dhe jo sipas gradave apo titujve. Duhet të përmendim që stafi akademik, jo në pak raste është I përfshirë dhe në punë administrative. Shpallja e vendit vacant, bëhet në faqen web të universitetit si dhe në site brenda dhe jashtë vendit. https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities,</p> <p><i>11. Rregullore e Universitetit Epoka për “Rekrutimin e Stafit”</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një numër të konsiderueshëm të stafit ndihmës akademik ose asistentë të cilët përfshihen në një sërë aktivitetesh të cilat përshkruhen në dokumentin shtojcë 69. Asistentët ndihmojnë në aktivitetet e departamentit, në seminare dhe laboratore, konferenca, asistojnë në menaxhimin e website të departamentit dhe faqeve sociale, asistojnë në aktivitetet e klubit të studentëve etj. Asistentët plotësojnë një formular me aktivitetin e tyre.</p> <p>Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 5, rezulton se Departamenti I Ekonomiksit për vitin 2022-2023 ka pranuar një student si asistent ndihmës akademik. Nuk kemi informacion nëse ky student është I përfshirë në këtë program studimi.</p> <p><i>69 Performanca e personelit ndihmës akademik.</i> <i>5 Vendim Bordit Administrativ - Asistentet Ndhimes (1)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të</p>	<p>Institucioni nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore mbledh dhe ruan të dhënat mbi personelin e angazhuar me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Gjatë vizitës në institucion janë marrë në shqyrtim dosje të rastësishme të</p>

<p>angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>stafit akademik. Institucioni nuk ka përditësuar CV e tyre dhe puna kërkimore shkencore si dhe ndarja e ngarkesës janë dokumenta që mbledhen nga Departamenti.</p> <p>Mbledhja e të dhënave rregullohet nga dokumenti I "Formulari Informativ i Stafit" shtojca 84. Formulari vjen si udhëzim I Komisionerit public "Për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale"</p> <p><i>71 Tabelat përmbledhëse [12.1-12.6]</i> <i>83 Ligji Nr. 9887 dt 10.03.2008 Mbi mbrojtjen e të dhënave Personale</i> <i>84 Formulari informativ i stafit</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka 66 marrëveshje me institucione brenda vendit dhe është pjesë e bashkëpunimeve me 9 institucione jashtë vendit. Marrëveshjet janë në rang Universiteti dhe jo specifike për këtë program studimi. Numri i studentëve në këtë program është i kufizuar dhe nuk krijon problem për mbulimin e tyre me vende praktike.</p> <p>Universiteti Epoka bashkëpunon me vendet e BE nëpërmjet programeve Erasmus+. Po kështu Universiteti Epoka ka përfutur dhe nga programi Tempus. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zyra e Hulumtimeve dhe Projekteve koordinojnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe projektet. Marrëveshjet me Institucionet Joarsimore menaxhohen nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit e cila ndihmon dhe studentët për realizimin me sukses të praktikës mësimore.</p> <p>Praktika është modul I detyrueshëm dhe zhvillohet në semestrin 5. Universiteti organizon cdo vit dhe Panairin e Karrierës për të ofruar më shumë studentët me tregun e punës.</p> <p><i>13 Kurrikula e programit të studimit</i> <i>41 Marrëveshjet active të bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Departamenti cakton një mbikqyrës për cdo student në udhëheqjen e tij në praktikën profesionale. Praktika është modul që vlerësohet me kredite dhe për më tepër është i rëndësishëm pasi vë në zbatim njohuritë teorike që kanë marrë studentët në tre vitet e shkollimit të tyre.</p> <p>Supervizori I praktikës angazhohet për gjetjen e vendit të praktikës së bashku me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit, harton një plan praktike për studentin, bashkëpunon me supervizorin në vendin e praktikës, vlerëson raportin e përgatitur nga student etj. Detyrat janë të përcaktuara në aneks 77.</p> <p><i>77 Udhezues për zhvillimin e praktikës profesionale</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore përfaqësuar vetëm nga një anëtar mban, ruan dhe mbledh të dhënat e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ konstaton se puna kërkimore shkencore e stafit akademik ruhet në Departamentin përkatës. GVJ konstaton se ndarja e ngarkesës bëhet mbështetur në nevojat e institucionit dhe jo sipas gradave apo titujve. Gjithashtu, GVJ konstaton se stafi akademik është i përfshirë dhe në detyra të tjera në Komisione apo punë të tjera administrative.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve	
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës dy ditore në institucion, GVJ u njoh me ambientet e punës së stafit akademik, ndihmës akademik dhe stafit administrativ. Universiteti Epoka ka ambiente komode dhe të përshtatshme për zhvillimin me sukses të programit të studimit. Ambientet e mësimit janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike. Institucioni ka laboratorë të pajisur me kompiuter për zhvillimin me sukses të moduleve që kërkojnë këto pajisje. Në të gjitha ambientet kishte internet wi-fi për studentët dhe stafin. Më shumë informacion gjendet në shtojcë 71 tabela 16.</p> <p><i>71 Tabelat përmbledhëse [16]</i></p>	
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer nga GVJ në institucion, vumë re se klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme elektronike për garantimin me sukses të procesit mësimor. Gjithashtu, institucioni zotëron laboratorë me 217 PC për studentë. Institucioni ka PC për stafin akademik dhe administrative, fotokopje, TV, skaner, printer, white board dhe pajisje të tjera të domosdoshme për zhvillimin e mësimit. Më shumë detaje mbi numrin e tyre gjenden në shtojcën 42.</p> <p><i>42 Informacion mbi infrastrukturën për funksionimin e PS</i></p>	
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga vizita në institucion, vlerësojmë se Universiteti Epoka ka mjaftueshëm paisje dhe infrastrukturë për përmbushjen me sukses të këtij program studimi. Shtojcë 42, jep detaje mbi numrin e paisjeve të cilat sigurisht përdoren dhe për programe të tjera studimi.</p> <p><i>42 Informacion mbi infrastrukturën për funksionimin e PS</i></p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni Epoka është i pajisur me 2 laboratorë dhe me salla të tjera kompiuterash për realizimin e programit të studimit. Zyra koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit ofron shërbime teknologjike për Universitetin. Informacion më i detajuar mbi paisjet elektronike gjendet në shtojcë 42</p> <p><i>42 Informacion mbi infrastrukturën për funksionimin e PS</i></p>	
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson mbështetur në vizitën në institucion, se Universiteti Epoka ka ambientet e pajisura me të gjitha paisjet e nevojshme dhe të domosdoshme për realizimin me sukses të programit të studimit. Infrastruktura është relativisht e re dhe bashkëkohore.</p>	
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

standardit		kryesisht	plotësisht
			X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në përputhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe mbështetur në vizitën e bërë në institucion na rezulton që Universiteti Epoka ka në dispozicion të studentëve të të gjithë programeve të studimit, një bibliotekë me rreth 25000 tituj fizik dhe rreth 2000 tituj në mënyrë elektronike. Hapësira prej rreth 400 metër katrorë me kapacitet rreth 100 persona është e mjaftueshme për ti siguruar studentëve komoditetin e nevojshëm për studim. Mbështetur në shtojcë 18, syllabuset e programit të studimit, vihet re se shumë module kanë një literaturë të vjetër dhe disa të tjera të paqartë pasi jepet vetëm titulli I librit por jo viti I botimit. Kështu psh vihet re: në modulën Consumer Behaviour, literatura është e paplotë dhe nuk ka literaturë shtesë, e njëjta situatë është dhe në modulën Introduction to Business. Në modulën German I, mungon viti I literaturës së përdorur. Në modulën Monetary Theory and Policy, botimi I përdorur është I vitit 2009, dhe literatura shtesë e vitit 2012. Labour economics 2015, Econometrics 2011, Public Finance 2014 dhe mungon literature shtesë etj. Institucioni duhet të përditësoj syllabuset dhe njëkohësisht titujt në bibliotekë me literaturën më të fundit. Kuptohet që ka module që kanë textbook të cilët nuk kanë nxjerrë ribotime në vitet e fundit si psh Microeconomics, por në literaturën shtesë mund të vendosen tituj të kohëve të fundit papers apo journals apo dhe literaturë vendase mbi punime apo doktoratura në këtë fushë.</p> <p><i>18 Syllabus të kursit për vitin 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Mbështetur në syllabuset e programit të studimit që ka dorëzuar institucioni, konkludojmë që nuk ka përditësim të literaturës në shumë module dhe si rrjedhim literatura nuk është përditësuar as në bibliotekë <i>Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 10, rezulton se Universiteti Epoka ka një procedurë të miratuar të pasurimit të bibliotekës sipas nevojave të stafit akademik mbështetur në kërkesat e studentëve apo objektivat e vendosura.</i></p> <p><i>10 Sample on Purchase of Books_Economics</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit Epoka është në një hapësirë të bollshme me pamje nga fushat, shumë e qetë dhe e përshtatshme për funksionin që ka. Biblioteka ka një fond të pasur të librave fizikë dhe elektronikë. Gjatë takimit me studentët u informuam që në shumicën e rasteve literatura e përdorur I vihej në dispozicion nga titullari I lëndës në mënyrë elektronike dhe më pak ata frekuentonin bibliotekën për të marrë libra. GVJ mendon se</p>

	<p>biblioteka I plotëson kushtet e studentëve si nga infrastruktura dhe mjedisi ashtu dhe nga titujt e ofruar të cilit ishin dhe përtej atyre të nevojshëm në procesin mësimor.</p> <p>Biblioteka ka dhe një faqe në web për të kontrolluar në detaje librat që ndodhen në të.</p> <p>http://lib.epoka.edu.al</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ashtu sic përshkruhet dhe në kriteret e mësipërme ka një numër të madh tekstesh dhe në gjuhë të ndryshme si shqip, anglisht, turqisht etj. Biblioteka ka hapësirën e nevojshme për studimin e literaturës nga studentët. Institucioni nuk ka dhënë informacion të mjaftueshëm mbi titujt e librave: shtojcë 27 jep të renditur disa tituj, shpesh në mënyrë të përsëritur, por nuk jep informacione mbi vitin e botimit, shtëpinë botuese, autorët etj.</p> <p><i>27 Lista e librave në bibliotekë</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni I ka dhënë akses studentëve dhe stafit akademik të aksesojnë në bibliotekën online në linkun http://lib.epoka.edu.al. Gjithashtu institucioni është abonuar në JSTOR. (www.jstor.org)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me kompiutera, ka akses në internet, ka mjaftueshëm poste për tu ulur dhe shfletuar librat, ka dritë natyrale.</p> <p>Biblioteka është për të gjithë institucionin por drejtuesit e saj na siguruan që nuk ka probleme në aksesimin e studentëve kjo e lidhur dhe me faktin që studentët për modulet e tyre në këtë PS përdorin literaturë online.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari I bibliotekës është në përputhje me orarin e punës në Universitetin Epoka. Orari I bibliotekës është I afishuar në ambjentet e bibliotekës. Orari është 8.30-16.30 (12.30-13.00 pushim). Orari është nga e hëna në të premte. GVJ sygjeron që ky orar mund të jetë më I gjatë sidomos në periudha të provimeve ku dhe kërkesat e studentëve mund të jenë më të mëdha.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit Epoka funksionon dhe është në shërbim të studentëve dhe stafit akademik. Funksionimi I saj rregullohet nga dokumenti " Direktivat e Bibliotekës", shtojcë 78. Në këtë document përshkruhen afatet e marrjes së librave, dorëzimi, mbajta e librave dhe rimarrja e tyre si dhe mënyra e funksionimit të bibliotekës.</p> <p><i>Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 10, rezulton se Universiteti Epoka ka një procedurë të miratuar dhe të aplikuar të pasurimit të bibliotekës sipas nevojave të stafit akademik mbështetur në kërkesat e studentëve apo objektivat e vendosura. GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit pr përmirësimin e infrastrukturës s bibliotekës.</i></p> <p><i>10 Sample on Purchase of Books_Economics</i> <i>27 List of all Books and periodicals in the Library</i> <i>78 Direktivat e bibliotekës</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ kostaton se në shumicën e rasteve, literatura nuk është e përditësuar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>dhe mungon literatura shitesë. Duke qënë se nuk ka përditësim në syllabus, rrjedhimisht dhe librat në bibliotekë nuk janë përditësuar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka disponon një Sistem Qendror të Menaxhimit të Informacionit I cili është Sistemi Interaktiv Epoka (EIS). EIS është zhvilluar nga Zyra Kordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të menaxhuar të gjithë informacionet që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga viti I parë deri në diplomim.</p> <p>EIS është një sistem modular I organizuar me ndërfaqës të ndryshëm sipas njësive dhe roleve në univeritet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash ku përdoruesit mund të regjistrohen duke përdorur llogarinë e emailit të universitetit dhe ta aksesojnë ate online nëpërmjet linkut www.eis.epoka.edu.al.</p> <p>Ky system I integruar lidh sekretarinë, studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>28 EIS Guida për studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi EIS është një sistem i përdorur gjerësisht nga studentët, stafi akademik si dhe strukturat e tjera administrative. Studentët aksesojnë në këtë sistem të dhënat e tyre personale dhe cdo informacion të nevojshëm në lidhje me programin e studimit. Studentët kontrollojnë datat e provimeve, regjistrimin në provim, notat paraprake apo dhe ato përfundimtare. Gjithashtu ata zotërojnë informacion në lidhje me programin e studimit, listë e notave, kërkesat e njoftimet e ndryshme në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Për personelin akademik, EIS jep informacion mbi modulën, notat, njoftimet e studentëve etj. Hapja e lëndëve bëhet nga kordinatorët e departamenteve. Sistemi EIS përdoret dhe nga Zyra e Regjistrimeve për ndjekjen e procesit të regjistrimit të studentëve, bursat etj.</p> <p><i>28 EIS Guida për studentët</i> <i>29 EIS Guida për lektorët</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi EIS nëpërmjet platformës së komunikimit bën të mundur integrimin e informacionit midis studentëve, stafit akademik, dhe strukturave të tjera organizative.</p> <p>Eshtë një sistem që bën të mundur komunikimin e studentit me pedagogun mbi zhvillimin e modulit, datën e provimit, leksionet, detyrat për dorëim, notën paraprake dhe atë përfundimtare. Ky komunik bëhet gjithmonë online duke lënë gjurmë dhe sigurisht krijon besueshmeri dhe transparencë.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të</p>	<p>Sistemi EIS bën të mundur ndërveprimin e sekretarisë me studentët dhe pedagogt si dhe me zyrat e tjera si Zyra e Burimeve Njerëzore apo me Zyrën</p>

aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	e Financës. Në këtë mënyrë komunikimi bëhet në kohë reale mbi pagesat, rjoftimet, dokumentat për dorëzim etj. Cdo përdorues përditëson të dhënat personale, CV, merr njoftimet përkatëse. Nga vizita në institucion GVJ vlerëson se sistemi EIS shtë një sistem që përdoret gjerësisht nga të gjithë hallkat e universitetit, është një sistem i mirëstrukturuar dhe eficient në përdorim.						
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Departamenti i Ekonomiksisht ka faqen e saj në web i cili aksesohet në këtë adresë: www.eco.epoka.edu.al . Në këtë hapësirë gjendet informacioni i nevojshëm mbi stafin akademik dhe administrativ, programet e studimit që ofrohen për të tre nivelet, mobilitetet, raportet vjetore etj.						
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe nga takimet e kryera atje, GVJ vlerëson se sistemi EIS është një sistem që përdoret gjerësisht nga të gjithë hallkat e universitetit, është një sistem i mirëstrukturuar dhe eficient në përdorim.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, Universiteti Epoka përcakton në Statutin e tij neni 4, çështjet që lidhen me buxhetin, financat. Sipas Statutit hartimi I buxhetit përgatitet nga Administratori bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësisë Kryesore dhe Njësitë Bazë. Ai aprovet nga Senati Akademik pasi është miratuar nga Bordi I Administrimit dhe është I realizuar në përputhje me standartet ligjore. <i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 4)</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të	Dokumentat e dorëzuara tregojnë për evidence të kostove dhe të ardhurave të siguruara nga Universiteti. [Tabela përmbledhëse, 18] Bazuar në informacionet e mësipërme GVJ konstaton se institucioni harton raporte financiare të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetje financiare të tij. Plani I financimit të programit të studimit I përmban të gjitha zërat që përcakton standarti si financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative etj. Universiteti I siguron të ardhurat nga tarifat e studentëve si dhe nga projekte të ndryshme. Pas hartimit të nevojave dhe miratimit të buxhetit nga Bordi, Administratori dhe Zyra e Financës ndjekin zbatimin e buxhetit sipas nevojave të institucionit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	71 Tabela përmbledhëse, tabela 18.		
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Mbështetur në RVB, Turgut Ozal sh.a kryen një audit vjetor të jashtëm. <i>Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 2, rezulton se Universiteti Epoka ka kryer në mënyrë periodike auditin e jashtëm.</i> RAPORTE 2020 RAPORTE 2019		
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nuk kemi informacionin e nevojshëm për këtë kriter		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Mbështetur në tabelat e paraqitura nga institucioni, të ardhurat nga tarifat e studentëve janë burimi kryesor I të ardhurave. Universiteti Epoka ka qëndrueshmëri financiare të shprehur dhe në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga takimet e bëra në institucion. Në programin e studimit Bsc Ekonomiks, numri I studentëve është I kufizuar, kështu që GVJ mendon se ky është një kërcënim për vijueshmërinë e programit të studimit.		
Konkluzione	GVJ mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar, vlerëson se institucioni mbështetet financiarisht nga tarifat e studentëve. GVJ mendon se për të pasur të ardhura të qëndrueshme institucioni duhet të hartojë plane afatmesme apo dhe afatgjata për qëndrueshmërinë e të ardhurave dhe garantimin e tyre dhe nga bashkëpunimet apo pjesëmarrjet në projekte.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të	Universiteti Epoka ka hartuar dhe zbaton politika të qarta në lidhje me studentët që në momentin e parë të regjistrimit dhe deri në diplomimit e tyre apo dhe më tej në procesin e punësimit.


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al




<p>studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka hartuar në mënyrë rigorozë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të siguruar vijmësinë e programit të studimit.</p> <p>Në shtojcë 5, rregullohet I gjithë procesi që nga regjistrimi I studentëve me kriteret e pranimit, ndihma nëpërmjet bursave, ndjekja dhe zhvillimi I mësimi, paisja me kartën e studentit, provimet, kreditet, transferimet dhe gjithshka tjetër që nevojitet në procesin e studimeve.</p> <p>Në shtojcë 7, rregullohet procesi I provimit për studentët që ndjekin studimet në nivelin Bsc. Procesi I provimeve si dhe kërkesat dhe njohuritë e nevojshme që duhet të ketë studenti përpara hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit dhe llogaritja e pikëve.</p> <p>Shtojca 44 jep informacion mbi kuotat e pranimit në të gjithë programet e studimit të ofruara nga Universiteti Epoka si dhe ndarjen sipas kategorive. Institucioni ofron bursa për studentët me arritje në shkollën e mesme apo provimin SAT të gjuhës së huaj. Shtojca 79, jep direktivat e ndarjes së bursave.</p> <p><i>5 Rregullore e Universitetit Epoka [Kapitulli 6-9]</i> <i>7 Rregullore Universitetit Epoka [Për studimet Bsc dhe provimet]</i> <i>44 Kuotat e pranimit të studentëve në ciklin e parë, ciklin e dytë të studimit apo diplomë të integruar për vitin akademik 2022-2023, miratuar nga Bordi Administrativ I Universitetit EPOKA</i> <i>79 Direktivat e Universitetit epoka mbi ndarjen e bursave</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takime me Përgjegjësin e Departamentit, Zyrën e Regjistrimeve dhe Kordinimit, Zyra e Sekretarisë Mësimore, na u konfirmua se numri I kuotave propozohet nga Bordi I Administrimit dhe miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Procedurat e regjistrimit të studentëve mbështeten në udhëzimet përkatëse të MAS. Kështu për tu regjistruar në Universitetin Epoka, duhet më parë të plotësosh Formularin A1/Z dhe më pas të regjistrohesh nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH).</p> <p>Procedurat dhe dokumentacioni janë në përputhje me udhëzimet e MAS për këtë process. Të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë.</p> <p><i>2 Statuti I Universitetit Epoka</i> <i>5 Rregullore e Universitetit Epoka</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se shtojca 5, përcakton qartësisht të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, të përparimit gjatë studimeve, të transferimit, të njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto kritere dhe procedura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme dhe në web të institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se informacioni publikohet dhe në rrjetet sociale si dhe të interesuarit mund të kontaktojnë Zyrën e Pranimeve në çdo moment të vitit. Ky informacion ndodhet dhe në broshurën Student Guide që I jepet studentin në momentin e parë të paraqitjes në institucion.</p> <p><i>5 Rregullore e Universitetit Epoka</i></p>




<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka hartuar dokumentacionin e nevojshëm për të siguruar vijmësinë e programit të studimit mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Në shtojcë 5, rregullohet I gjithë procesi që nga regjistrimi I studentëve me kriteret e pranimit, ndihma nëpërmjet bursave, ndjekja dhe zhvillimi I mësimi, paisja me karten e studentit, provimet, kreditet, transferimet dhe gjithshka tjetër që nevojitet në procesin e studimeve.</p> <p>Studenti njihet me këtë informacion në momentin e parë që I drejtohet institucionit fizikisht ose online nëpërmjet web apo faqeve sociale.</p> <p><i>5 Rregullore e Universitetit Epoka</i></p>						
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka zhvillon takime informuese për maturanët përpara nisjes së provimeve të maturës shtetërore, ku I informon ata mbi data e aplikimit, programet e studimit, tarifat, kriteret e pranimit atj. Gjatë visitës në institucion, u informuam që është Zyra e Pranimeve ajo që merret me njoftimin e studentëve. Studentët potencial ftohen në kampus për të parë dhe infrastrukturën si pjesë e rëndësishme e procesit të mësimi.</p>						
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Universiteti Epoka mbështet arsimin gjithëpërfshirës. Universiteti është pjesë e programit IDEA në ndihmë të studentëve me aftësi të vecanta.</p> <p>Universiteti ka krijuar një ekip të aksesueshmërisë me anëtarë nga cdo njësi. Universiteti Epoka nuk ka kriteret e vecanta pranimi për personat me aftësi të vecanta.</p> <p><i>50 Skuadra e aksesueshmërisë</i></p>						
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Shtojca 44 jep informacion mbi kuotat e pranimit në të gjithë programet e studimit të ofruara nga Universiteti Epoka si dhe ndarjen sipas kategorive. Universiteti I referohet udhëzimeve të MAS mbi pranimet në programet e studimit. Institucioni pranon studentë të huaj në ciklin e parë të studimit, nëse ata plotësojnë kriteret e pranimit.</p> <p><i>44 Kuotat e pranimit të studentëve në ciklin e parë, ciklin e dytë të studimit apo diplomë të integruar për vitin akademik 2022-2023, miratuar nga Bordi Administrativ I Universitetit EPOKA</i></p>						
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Universiteti Epoka jep bursa merite për studentët me rezultate të larta por institucioni përpiket të jetë pranë komunitetit dhe duke shpërndarë bursa për kategori të vecanta si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fëmijë të policëve të vrarë në krye të detyrës 2. Fëmijëve jetim me të ardhura të ulta 3. Studentë që I përkasin komunitetit rom/egjiptian 4. Studentë nga Vora 5. Sportistë elitar <p><i>49 Vendimi I Bordit për bursat sociale</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti ndjek procedurat e duhura mbështetur në aktet ligjore në fuqi, për pranimin, regjistrimin dhe diplomimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bsc Ekonomiks.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%;"></th> <th style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, shtojca 5 & 7, si dhe në takimet e organizuara me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se Universiteti ju mundëson studentëve akses të plotë në sistemin e informacionit EIS, ku ata mund të marrin të gjithë informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe ato për kalimin nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>5 Rregullore e Universitetit Epoka</i> <i>7 Rregullore Universitetit Epoka [Për studimet Bsc dhe provimet]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, shtojca 5, GVJ konstaton se Universiteti Epoka aplikon procedurat e kualifikimeve të mëparshme, studimeve të pjesshme, ose transferimeve të studentëve duke u mbështetur te Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, si dhe në kushtet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjatë intervistës me Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomiksit dhe mbështetur në rregullore, transferimet mund të kryhen nga semestri 3 deri në semestrin 5 dhe studentit mund ti njihen deri në 2/3 e lëndëve të zhvilluara më parë. Studentët regjistrohen në Zyrën e Pranimit, plotësojnë formularin përkatës dhe e paraqesin atë pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore. Aplikimet shqyrtohen nga Departamenti dhe I përcillen Dekanit të Fakultetit për miratimin përfundimtar. GVJ konstaton se studentët e interesuar mund ta gjejnë këtë informacion dhe në faqen zyrtare web të institucionit. Transferimet mund të kryhen ndërmjet programeve të ngjashme brenda apo jashtë universitetit.</p> <p>https://registrar.epoka.edu.al.</p> <p><i>5 Rregullore e Universitetit Epoka, Neni 41 "Mbi transferimin e studimeve"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, pedagogët dhe përfaqësuesit e Zyrës së Pranimeve GVJ u informua se që në fillim të vitit të parë akademik të studimeve të tyre studentët marrin broshurën "Student guide" e cila është një udhëzues praktik me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit (kohëgjatja e studimeve, organizimin e programit, pjesëmarrjen në klasë dhe vlerësimin). Gjithashtu informacioni në lidhje me modulet përmbajtjen e lëndës, objektivat, literaturën dhe mënyrën e vlerësimit për çdo modul, studentët njihen në fillim të semestrit. Ky informacion jepet nga pedagogu i lëndës të cilët prezantojnë syllabusin e lëndës. Po kështu, Universiteti zhvillon dhe ditët e dyerve të hapura.</p> <p><i>9 Student Guide</i> <i>18 Syllabuset e kursit 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka përcaktuar të gjitha kriteret dhe procedurat për kryerjen e punimit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>diplomës në programin e studimit Bsc Ekonomiks. Studentët vlerësohen për punimin e diplomës në varësi të rezultateve të arritura në provime. Studentët me mesatare mbi 2.00 konsiderohen që I kanë plotësuar kërkesat e diplomimit ndërsa studentët me mesatare nën 2.00 marrin provime shtesë për lëndët në të cilat nuk kanë arritur rezultate të mira.</p> <p><i>5 Rregullore e Universitetit Epoka, Neni 41 "Mbi transferimin e studimeve"</i> <i>7 Rregullore Universitetit Epoka [Për studimet Bsc dhe provimet]</i></p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Ashtu siç kemi përmendur dhe në standartet e mëparshme të këtij raporti, Universiteti Epoka zhvillon çdo vit takime informuese me maturantët, disa muaj përpara maturës shtetërore dhe vendimarrjes së tyre për përzgjedhjen e Universitetit dhe programit të studimit. Gjithashtu, institucioni zhvillon dhe ditet e dyerve të hapura për të informuar maturantët apo gjimnazistët mbi infrastrukturën e institucionit informacion në lidhje me detajet e çdo program studimi.</p> <p>GVJ konstaton se të interesuarit kanë informacionin e nevojshëm në faqen e web e cila është e mirëorganizuar dhe funksionale.</p> <p>Po këshut Zyra e Pranimeve është funksionale gjatë gjithë vitit për të interesuarit rreth këtij institucioni apo programeve të studimit që ai ofron.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Institucioni mundëson të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që në momentin e regjistrimit të tyre në një program studimi e deri në diplomim.</i></p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 976 746 1043">Përbushet</th> <th data-bbox="751 976 954 1043">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="959 976 1177 1043">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1182 976 1410 1043">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						



Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Ekonomiks ka një kohëzgjatje 3 vite (6 semestra) dhe në fund të këtij program studenti ka 180 kredite europiane (ECTS). Me mbarimin e studimeve, studenti merr diplomë Bsc në Ekonomiks (mbështetur në Statutin e Universitetit Epoka).</p> <p>Ky informacion ndahet me studentët që në momentin e parë atë të regjistrimit. Informacioni është i detajuar dhe në faqen web të institucionit. Po këshut në web ka informacion në lidhje me departamentin, stafin, programet e studimit që departamenti ofron etj.</p> <p>www.ecoepoka.edu.al</p> <p><i>2 Statuti i Universitetit Epoka</i> <i>13 Kurriкулumi e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,</p>	<p>Të gjithë informacionin në lidhje me strukturën e këtij programi studimi, organizimin dhe kohëzgjatjen, studentët e marrin që në nisje të studimeve nga Zyra e pranimeve me anë të broshurës "Student Guide" si dhe nga koordinatori I programit të studimit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ vlerëson se në pikënisje të semestrit, pedagogët ndajnë informacion në lidhje me modulën dhe të gjithë elementët e syllabusit.</p> <p>Cdo informacion i nevojshëm duke nisur që nga kriteret e pranimit, pagesa, kreditet, modulet, syllabuset dhe cdo elementë tjetër gjenden në faqen e web: www.epoka.edu.al</p> <p><i>2 Statuti I Universitetit Epoka</i> <i>13 Kurrikula e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar tek dokumentat e dorëzuara nga institucioni si dhe tek RVB, konstatojmë se Zyra e Planifikimit të Karrierës informon studentët mbi praktikën profesionale dhe mundësitë e punësimit. Kjo zyrë së bashku me Departamentet përkatëse mban lidhje me organizatat publike apo private me qëllim orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Në bashkëpunim këto struktura organizojnë Panairin e Karrierës për të prezantuar tëk studentët mundësitë e punësimit. Në faqen e web gjithashtu ka afishime të mundësive të praktikës apo punësimit: www.cpaio.epoka.edu.al. Gjithashtu Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar, mban lidhje me studentët alumni dhe kryen në mënyrë periodike studime tregu mbi punësimin e studentëve të diplomuar në të gjitha programet e studimit. Kjo zyrë organizon në bashkëpunim me strukturat e tjera të universitetit aktivitete të ndryshme si: Forum I Hapur, Panairi I Karrierës, Vizita në Kompani.</p> <p>Mundësitë e punësimit paraqiten në Panairin e Karrierës ku marrin pjesë rreth 100 firma. Këto mundësi punësimi paraqiten gjatë gjithë vitit duke u afishuar në webin e institucionit apo duke i lajmëruar të interesuarit npmjet adresave të email apo në rrjetet sociale.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ pas vizitave me studentët dhe pedagogët, vlerëson përpjekjet e Departamentit të Ekonomiksit I cili cdo fillim viti akademik shpall në ambientet publike orarin mësimor, ditën, orën, sallën dhe personelin përkatës për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu studentët marrin informacionin dhe nëpërmjet broshurës “Guida e studentit” shtojcë 9.</p> <p><i>9 Guida e studentit</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Ashtu sic kemi cituar dhe më lartë, studentët kanë informacioni e duhur në lidhje me programin e studimit nëpërmjet përdorimit të sistemit EIS. Nëpërmjet sistemit ata regjistrohen në provime, kontrollojnë statusin e tyre gjatë semestrit dhe vitit akademik, marrin njoftim për data e provimeve, notën paraprake dhe atë përfundimtare. Po nëpërmjet këtij sistemi ata marrin informacionin e duhur mbi kurrikulën ndarjen në kredite, gjenerojnë listë notash, marrin njoftimet nga pedagogët etj.</p> <p><i>28 Guida EIS për studentët</i> <i>29 Guida EIS për stafin</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni mundëson të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që në momentin e regjistrimit të tyre në një program studimi e deri në diplomim.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

standardit		kryesisht	plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton nga vizitat në institucion dhe dokumentat e dorëzuara, që Sekretaria Mësimore mban të dhëna në lidhje me regjistrimet, transferimet, notat mesatare në hyrje dhe në dalje të studentëve, largimet e të tjera të dhëna. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësi të vëzhgojë dhe regjistrat themeltar apo regjistrin e notave. Të dhënat në sekretari ruhen në format fizik po dhe elektronik nëpërmjet sistemit EIS. Në dokumentat e dorëzuara nga institucioni këto të dhëna jepen në aneks 71. Këto statistika janë dhe në përmbushje të detyrimeve që ka institucioni ndaj MAS apo QSHA. <i>71 Tabela përmbledhëse [Tabelat 19-23]</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore në institucion, GVJ vëzhgoi regjistrin themeltar të studentëve. Studentët janë të pajisur me numër matrikullimi. Në regjistër identifikohen lehtësisht transferimet. Në dokumentat e dorëzuara, universiteti ka statistika për studentët në 5 vitet e fundit ku jepen detaje mbi numrin e studentëve, largimet, transferimet, cilësia në hyrje dhe në dalje, si dhe numrin e studentëve të diplomuar në cdo vit akademik. <i>71 Tabela përmbledhëse [Tabelat 19-23]</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore operon mbështetur në neni 101 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr 80/2015. I gjithë informacioni ruhet në systemin e brendshëm EIS. Për rregullimin e procesit nga zyrat përkatëse institucioni ka përpiluar dokumentat e paraqitura në shtojcën 28, 29, 67. Të dhënat për ecurinë e studentëve ruhen në procesverbale në systemin EIS, si dhe në hard copy në regjistrin e notave. GVJ i konstatoi këto dokumenta gjatë vizitës në institucion. <i>28 Guida EIS për studentët</i> <i>29 Guida EIS për stafin</i> <i>67 Shërbimet e Zyrës ICTC</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretari të mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me	Sistemi i brendshëm i informacionit EIS është i ndërtuar në module dhe i mundëson raporte të personalizuar të gjithë pjesëtarëve që kanë akses në të. ndërmjet ti menaxhohen të gjithë të dhënat e studentëve në lidhje me veprimtaritë e tyre msimore. Në këtë system kanë akses studentët në llogaritë e tyre personale, pedagogët në modulet e tyre të lëndëve që drejtojnë si dhe sekretaria apo zyra të tjera sipas llogarive të tyre. Të gjitha zyrat që kanë akses dhe përpunojnë të dhënat, e bëjnë këtë duke ruajtur konfidencialitetin dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky informacion aksesohet vetëm nga personan e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>autorizuar.</p> <p>Universiteti ka dhe gурpin e auditimit të brendshëm I cili kryen kontrole periodike për procedurat e punës së njësite.</p> <p>82 <i>Politkat e Cilësisë</i> 85 <i>Formulari I mospërputhjes</i> 90 <i>Vendim I Rektoratit "Ngritja e Grupit të Auditimit të Brendshëm"</i></p>								
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore harton raporte vjetore mbi të dhënat e studentëve në hyrje por dhe ato egzistues. Këto raporte vjetore janë dhe në përmbushje të detyrimeve që ka institucioni për të raportuar në MAS. Raportet vjetore janë të afishuara dhe në faqene web.</p> <p>Nga shtojcë 71, tabela përmbledhëse, vihet re numri I vogël I të punësuarve nga ky program studimi.</p> <p>Zyra e Sekretarisë vetem mban statistika por nuk bën raporte të detajuara apo analiza afatmesme dhe afatgjata. Departamenti duhet të analizojë më në detaje të dhënat e gjeneruara nga sekretaria.</p> <p>Zyra e planifikimit të Karrierës kryen në mënyrë periodike pyetësor me studentët e diplomuar në rang Universiteti. Në totalin e përgjigjeve, studentët të ekonomiksit janë pak, sepse dhe gjatë studimeve numri I tyre është I kufizuar.</p> <p>16 <i>Pyetësor për alumni</i> 71 <i>Tabela përmbledhëse [Tabela 19-26]</i></p>								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni gjeneron të dhëna dhe statistika për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit të ofruara nga Universiteti Epoka. Institucioni duhet të bëjë analiza dhe të hartojë strategji mbi problematikat në lidhje me regjistrimet, diplomimet, cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, si dhe për punësimin e tyre mbështetur në njohuritë e marra në Universitet.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>GVJ konstaton mbështetur në dokumentat që institucioni ka dorëzuar dhe nga takimet e kryera se përfshirja e studentëve dhe angazhimi I tyre në organet vendimmarrëse bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi (neni 98 dhe 99 I Ligjit 80/2015) dhe garantohet nëpërmjet dokumentit shtojcë 2, Statuti I Universitetit Epoka. Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senatin Akademik - Bordin e Etikës - Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>- Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore</p> <p>Përfaqësuesit e studentëve në këto organe zgjidhen nga Këshilli Studentor. Ky këshill është organi më i rëndësishëm studentor i Universitetit Epoka. Ky këshill përbëhet nga studentë të cilët janë përzgjedhur nëpërmjet një procesi votimi i studentëve. Ky proces bazohet në nenin 118 të Universitetit Epoka.</p> <p><i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 15,16,29,34,35)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në këto organe dhe përfaqësimi i tyre siguron në komisione dhe këshilla, siguron cilësi në procesin akademik.</p> <p>Përfaqësimi i studentëve në Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore siguron përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në dhënien e rekomandimeve për Senatën Akademik për çështje të ndryshme që lidhen me aktivitetet jashtëshkollore të kryera nga klubet studentore, jetën e studentëve në ambientet universitare dhe shërbimet e ofruara për ta etj.</p> <p>Në bazë të bisedave të kryera me studentët dhe Përgjegjës të Departamentit vumë re se përfshirja e studentëve në këto organizma është reale dhe konkrete duke adresuar shqetësimet e tyre në autoritetet vendimmarrëse.</p> <p><i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 15,16,29,34,35)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dorëzuara (Statuti I Universitetit Epoka) programi i studimit Bsc Ekonomiks ka 180 kredite europiane dhe kohëzgjatje 3 vite akademike ose 6 semestra. Cdo semester ka 30 kredite. Kreditet minimale për një modul janë 5 ECTS dhe maksimale janë 6 ECTS.</p> <p>Përsa i përket përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programit të studimit, në përmbajtjen e tij apo në vlerësimin për stafin akademik apo infrastrukturën, studentët e bëjnë këtë duke plotësuar në mënyrë periodike pyetësorë. Pyetësorët janë anonym dhe lihen në dëshirë të studentëve.</p> <p>Ndërsa përfaqësuesit e tyre në organizmat e sipërcituar, bën që zëri i tyre të dëgjohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shqetësimet e tyre të trasmetohen.</p> <p><i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 15,16,29,34,35)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të dorëzuara nga institucioni dhe mbështetur në takimin që GVJ zhvilloi me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë, u informuam se Zyra inkurajon studentët plotësojnë Anketat e Vlerësimit të Instrukturëve të Lëndës.</p> <p>Departamenti përpunon të dhënat e marra dhe merr masa të nevojshme.</p> <p>Në RVB nuk ka ndonjë referencë mbi raportimet që zhvillon departamenti në lidhje me shqetësimet që studentët mund të shfaqin.</p> <p>Në lidhje me shqetësimin e studentëve për vlerësimin në provime, në takimet e zhvilluara në institucion u informuam që studentët mund të ankimojnë notën dhe ti nenshtrohen një procesi rishikimi Brenda një jave nga dalja e notës paraprake në systemin EIS.</p> <p><i>7 Rregullore e Universitetit Epoka për provimet universitare</i> <i>54 Procedura e ankesave të studentëve për provimet</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se studentët janë të përfaqësuar në komisionet apo organet drejtuese mbështetur në rregulloren dhe Statutin e Universitetit Epoka.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	mbush	pjesor	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Ashtu sic është cituar dhe më lart në këtë raport, Universiteti Epoka ka njësi të posaçme Zyrën e pranimeve, në shërbim të informimit të studentëve. Që në fillim të studimeve të tyre studentët pajisen me broshurën “Guida e Studentit” një udhëzues praktik me informacionin e nevojshëm në lidhje me institucionin, funksionimin e tij dhe konkretisht informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit.</p> <p>Dekani I Studentëve mban në mënyrë të vazhdueshme në bazë ditore ankesat e studentëve për çeshtje lidhur me provimet por dhe çeshtje të tjera që mund të dalin gjatë përmbushjes së programit të studimit. Këto ankesa bëhen nëpërmjet procedurave të përcaktuara më parë dhe jepen nga shtojca 54, 55.</p> <p>Ankesat apo shqetësimet e studentëve vlerësohen nga Dekani, Administratori dhe njësitë përgjegjëse ku janë adresuar ankesat.</p> <p>Më pas Zyra e Dekanit të Studentëve I kthen përgjigje me email studentëve për çështjen që ata kanë ngritur.</p> <p><i>54 Procedurat e ankesave të studentëve për provimet</i> <i>55 Procedurat e ankesave të studentëve për çeshtje të tjera</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët pajisen që në javën e parë me një llogari të Universitetit Epoka, dhe në bazë të këtij emaili të hapur nga institucioni ata kanë akses në systemin EIS ku më pas ndjekin të gjitha procedurat të cilat janë përshkruar dhe më lart.</p> <p>Zyra e Sekraterisë Mësimore dhe Zyra e Koordinimit të Studentëve janë njësitë e posaçme të dedikuara për shqetësimet, pyetjet dhe pasiguritë e studentëve. Gjithashtu dhe Departamenti përkatës në këtë rast I Ekonomiksit luan një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen me sukses të programit të studimit.</p> <p>Sic e kemi theksuar dhe më lart, numri I studentëve në këtë program është I vogël (në vitin actual ka 22 studentë) gjë që nuk përbën problem nga Departamenti për të ndjekur ecurinë e studentëve.</p> <p>Një rol të rëndësishëm luan dhe Zyra e pranimeve në pajisjen e tyre me Guidën e Studentit apo dhe Zyra e Dekanit të Studentëve në ndjekje të shqetësimeve të tyre.</p> <p>Ne si GVJ, mendojmë se institucioni ka struktura të organizuara mirë për informimin, këshillimin dhe ndjekjen me sukses të studentëve në rrugëtimin e tyre 3 vjecar në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar studentët informohen në lidhje me programin e studimit dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre në ndjekje të këtij programi. Ata orientohen për praktikën</p>

e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	profesionale një modul shumë i rëndësishëm por dhe për trgeun e punës. Zyra orienton studentët në botën e biznesit dhe punësimin e tyre. Kjo Zyrë organizon këshillime për përgatitjen e CV, intervistat në aplikime, plotësimi i një letër motivimi. Kjo Zyrë organizon Panairin e Karrierës.		
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar ZPKD ndjek studentët dhe pas diplomimit të tyre nëpërmjet kontakteve individuale. Ajo mban kontakte të vazhdueshme me ta dhe ps punësimit të tyre. Studentët alumni shpesh ftohen në takimet apo aktivitetet që Departamenti apo Universiteti zhvillon në mënyrë që lidhje të jetë sa më e fortë. Në tabelat përmbledhëse ka informacion mbi punësimin e tyre. Zyra mban vetëm statistika por nuk zhvillon raporte apo strategji për të pasur një punësim sa më të lartë të studentëve të tyre.		
Konkluzione	GVJ konstaton se studentët janë të mirëpritur nga ZPKD q në momentin e parë të regjistrimit të tyre e deri në diplomim. Po kështu, departamenti ndjek hap pah hapi studentët duke I mbështetur ata në realizimin me sukses të praktikës por dhe në mbështetje të tyre pas diplomimit në tregun e punës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr 80/2015. Struktura kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Komisioni I Përhershëm për sigurimin e Cilësisë. Universiteti Epoka në shtojcë 3, ka hartuar dokumentn Strategjia Kornizë e Universitetit Epoka 2018-2022. Institucioni në këtë document jep prioritetet e Universitetit dhe pritshmëritë për 2018-2022. GVJ vlerëson se ky document është I vjetëruar dhe institucioni duhet tashmë të kishtë përpiluar tjetër document strategjik. Prioritetet ndryshojnë dhe për momentin prioriteti kryesor dhe i MAS është ndërkombëtarizimi I IAL.

	<p>Institucioni duhet të hartojë urgjentisht një document të ri. Institucioni ka përdorur metoda inovative të mësimdhënies në kohën e Covid-19.</p> <p><i>3 Strategjia Korzinë e Universitetit Epoka</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave të dorëzuara konstaton se sistemi I Brendshëm I Sigurimit të Cilësisë I përbërë nga Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë e tij, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni I Zhvillimit të Provimeve dhe Bordi I Provimeve operojnë në përputhje me Statutin e Universitetit.</p> <p>Të gjithë këto struktura kanë në focus evidentimin dhe ndjekejen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit, si dhe ndjekjen dhe plotësimin me vërtetësi të pyetësorëve të organizuar për studentët actual dhe ata alumni.</p> <p><i>12 Politikat e Universitetit Epoka në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit</i> <i>38 Manuali për Sigurimin e Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Mbështetur në dokumentat e dorëzuar nga institucioni si dhe nga takimet e kryera, GVJ vlerëson se ka dy mekanizma që bëjnë të mundur që studentët të japin vlerësimin e tyre.</p> <p>-Anketa e vlerësimit të Instruktorit të lëndës -Procedura për anketa të studentëve për çeshtje të tjera akademike</p> <p>Anketa e parë përmban 14 pyetje në lidhje me pedagogun e lëndës mbi përpikmërinë e tij në orën e mësimit, zotërimin e lëndës, mbi vlerësimin, materialin e përdorur, ndërveprimin me studentët etj.</p> <p>Procedura e dytë përfaqëson ankesat e studentëve në zyrën e Dekanit të studentëve për çeshtje të tjera akademik (procedura është përmendur dhe më lart).</p> <p>GVJ vlerëson metodat e përdorura nga Universiteti për vlerësimin dhe mundësinë e trajtimit të ankesave të studentëve.</p> <p><i>26 Anketa e Vlerësimit të Instruktorit të lëndës</i> <i>55 Procedura për anketa të studentëve për çeshtje të tjera akademike</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Universiteti Epoka bën publike të gjithë aktivitetin e njërive të sigurimit të cilësisë në faqen e saj të web. Aty gjëndet informacioni mbi anëtarët e njërive si: Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë e tij, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni I Zhvillimit të Provimeve dhe Bordi I Provimeve. Në faqen e web ndodhet I afishuar dhe raporti vjetor që përgatit kjo njësi.</p> <p>Gjithashtu Universitetid dorëzon në MAS raportime të vazhdueshme në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Universiteti publikon Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe Raportet e Vlerësimit të Jashtëm në faqen web: www.aeqi.epoka.edu.al</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, shtojcë 8 & 88, institucioni vlerëson performancën akademike të stafit akademik si dhe performancën e stafit administrative. Institucioni nëpërmjet njërive të sigurimit të cilësisë</p>

shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	organizon trajnime të ndryshme me studentët dhe stafin për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrative. GVJ e ka të paqartë se si institucioni I përdor këto mekanizma për vlerësimin e të punësuarve të saj staf akademik dhe administrativ. <i>8 Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative për përmirësimin e cilësisë</i> <i>88 Formulari për vlerësimin dhe matjen e performancës akademike</i>						
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ndjek dhe kryen procedurat e anketimit për Sigurimin e Cilësisë si metodë direkte për garantimin e cilësisë. GVJ konstaton se nuk ka raporte të mirëfillta apo plan veprimi nga Komisioni I Përhershëm I Sigurimit të Cilësisë. Kjo ndoshta për faktin se anëtarët e këtij komisioni janë dhe pjesë e stafit akademik të ngarkuar me mësimdhënie apo dhe process kërkimor – shkencor.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sipas Statutit të Universitetit Epoka, neni 35, Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ në bazë të dokumentave të dorëzuara konstaton se sistemi I Brendshëm I Sigurimit të Cilësisë I përbërë nga Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë e tij, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni I Zhvillimit të Provimeve dhe Bordi I Provimeve operojnë në përputhje me Statutin e Universitetit si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 35, 37, 38)</i> <i>6 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>8 Direktiva e Universitetit Epoka "Për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë"</i> <i>38 Manuali për sigurimin e Cilësisë</i> <i>82 Politika e Cilësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sipas RVB dhe dokumentave të dorëzuara nga institucioni, GVJ konstaton se institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit të ciklit të parë. Institucioni përdor anketimet me studentët dhe përpilon raporte mbi rezultatet e anketimeve periodike. Nëse departamenti konstaton se kurrikula ka nevojë për ndryshime, kërkesa e tyre shqyrtohet fillimisht nga Dekanati. Më pas propozimet shkojnë në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave. Komisioni I Përhershëm për

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Sigurimin e Cilësisë shqyrton kërkesën dhe më pas kalon në Senatën Akademik. Studentët janë pjesë e komisioneve sic është theksuar dhe në standartin më lart. Po kështu dhe pedagogët janë të përfshirë në këto procese.</p> <p><i>Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 8, rezulton se Universiteti Epoka nëpërmjet Vendimit të Senatit ka ngritur Komisionin e Prershëm për Sigurimin e Cilësisë për përfshirjen në këtë grup të një student alumni dhe një eksperti të jashtëm.</i></p> <p><i>8 - Anëtarët e KPSC.pdf</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka ngritur njësitë për Sigurimin e Cilësisë. Funksionimi i tyre rregullohet sipas dokumentave përkatës,: Statuti i Universitetit Epoka, Rregulore mbi funksionimin e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe përdor instrumentat e nevojshëm nëpërmjet anketave të zhvilluara me stafin dhe studentët.</p> <p>Të gjitha këto sigurojnë sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Nga ana tjetër, Universiteti Epoka siguron dhe vlerësimin e jashtëm të cilësisë nëpërmjet akreditimit të institucionit apo dhe programeve të studimit në mënyrë periodike.</p> <p>RVB dhe RVJ janë të shfaqura në web të institucionit.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe mbështetur në bisedat me pedagogët, studentët dhe njësitë e ndryshme në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika të qarta mbi sigurimin e cilësisë. Përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa e studentëve në lidhje me shërbimet e ofruara nga Universiteti • Anketa e vlerësimit të Lektorit • Anketa e Alumnit • Anketa e Pedagogëve <p>Në bazë të këtyre anketimeve, institucioni përgatit raporte me të dhëna sasiore dhe cilësore, analiza dhe plan veprimi.</p> <p>Institucioni përgatit dhe raporte vjetore si dhe analiza mbi ecurinë dhe vlerësimin e programit të studimit. Këto raporte japin vlerësimin e studentëve për programin dhe stafin akademik.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ka raporte vjetore të paraqitura dhe në faqen e web por nuk ka dokumenta mbi raportin e departamentit dhe qëndrimin e tij karshi problematikave të paraqitura në këto anketime.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka një dokument të vjetëruar të Strategjisë së Institucionit.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka raporte vjetore të paraqitura dhe në faqen e web por nuk ka dokumenta mbi raportin e departamentit dhe qëndrimin e tij karshi problematikave të paraqitura në këto anketime. Gjithashtu institucioni ka një dokument të vjetëruar të Strategjisë së Institucionit.</i></p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësi, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se Universiteti Epoka kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programit të studimit në kuadër të procesit të akreditimit.</p> <p>Institucioni realizon raporte vjetore për të treguar ecurinë e programit të studimit nëpërmjet treguesve për stafin akademik apo dhe performancën e studentëve si kalueshmëria, notat në hyrje apo në dalje.</p> <p>Këto raporte janë dhe në web të institucionit të aksesueshme nga e gjithë audienca.</p> <p>www.aeqi.epoka.edu.al</p> <p><i>12 Politika për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit</i> <i>34 Procedura për ndryshimin e planit mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Institucioni përgatit raporte vjetore me rezultatet e vlerësimit, motivimit dhe arritjet e Departamentit. Këto raporte hartohen mbështetur në anketimet e zhvilluara (cituat më lartë) si dhe nga të dhënat e mbledhura nga Zyra e Regjistrimeve apo dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p>Institucioni në shtojcë 80, jep Vendimet e Senatit Akademik mbi reflektimet në sygjerimet e bëran ga RVJ të Ascal.</p> <p>Për programin e studimit Bsc Ekonomiks, sygjerimet e bëra në akreditimin e kaluar jepen në stutusin ongoing.</p> <p>Institucioni nuk jep një document që të tregoj ndryshimet apo reflektimet nga raportet e marra nga anketimet. Ka template si shtojca 26, por institucioni nuk ka dorëzuar një plan veprimi të departamentit ndaj reflektimeve të anketave të zhvilluara.</p> <p><i>26 Instruksionet e kursit nga anketa e vlerësimit të lektorit</i> <i>80 Vendimi I Senatit Akademik në përgjigje të rekomandimeve të Ascal</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ u informua gjatë visitës në institucion me Përgjegjësin e Departamentit dhe stafin akademik se përvec metodave të standartizuara të kontrollit si anketat, departamenti zhvillon dhe kontrole në orë të leksioneve apo leksione të hapura.</p> <p>Me qëllim përmirësimin e cilësisë së stafit akademik në mësimdhënie, duke qënë se Universiteti ka dhe një staf relativisht të ri në moshe, organizohen dhe trajnime të stafit për metodat e mësimdhënies si dhe përshtatja me ndryshimet teknologjike.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Përveç metodave të drejtpërdrejta të kontrollit për mbarëvajtjen e programit të studimit, institucioni përdor dhe metoda të tërthorta nëpërmjet sondazheve me studentët alumni dhe bizneset që përfshijnë studentët në institucionet etyre për praktikën profesionale. Kjo bëhet për të vlerësuar programin e studimit dhe përputhjen e tij me tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu institucioni vlerëson mendimin e studentëve jo vetëm në lidhje me procesin mësimor dhe vlerësimet me nota, por dhe për ceshtje të tjera lidhur me organizimin, infrastrukturën, aksesin në teknologji etj. (është përmendur dhe më lartë ne standard)</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti Epoka kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programit të studimit në kuadër të procesit të akreditimit. Institucioni realizon raporte vjetore për të treguar ecurinë e programit të studimit nëpërmjet treguesve për stafin akademik apo dhe performanceën e studentëve si kalueshmëria, notat në hyrje apo në dalje. GVJ konstaton se institucioni mban statistika por duhet të realizojë raporte apo plane strategjike.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ashtu sic kemi përmendur dhe më parë në këtë raport, Universiteti Epoka ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Struktura kryesore është Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë I cili përbëhet nga nën njësitë e tij: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni I Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi I Provimeve. Struktura dhe funksionimi I njërive përkatëse janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit Epoka, Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e PCQA si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë së Universitetit Epoka. Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga 11 anëtarë ku dy janë përfaqësues të studentëve dhe alumni dhe një ekspert I jashtëm.</p> <p><i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 11,12,35,37, 38,108,109)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me</p>	<p>Në bazë të dokumentave të dorëzuar si dhe RVB, struktura funksionimi dhe detyrat e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe nën njërive të tij përcaktohen në Statutin e Universitetit Epoka.</p> <p>Një rol në sigurimin e cilësisë luan dhe departamenti përkatës. Detyrat dhe funksionet e këtyre njërive si dhe përfshirja në këto procese e pedagogëve, studentëve, si dhe administratës në këto njësi janë të përcaktuara në Statutin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përgjegjësi të këtyre detyrave.	e Universitetit Epoka. <i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 11,12,35,37, 38,108,109)</i>						
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në raportet e vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit ka të përfshirë studentë dhe staf akademik. Megjithatë kjo është një kërkesë e ASCAL. Nga ana tjetër, GVJ vëren se anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në pjesën më të madhe janë dhe staf akademik apo kryejnë dhe detyra të tjera në Institucion. Në RVB, nuk është e qartë ndarja dhe përfshirja e punës së secilit anëtar të këtij komisioni apo njesive të tjera.						
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe bisedave të zhvilluara në institucion, konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektuar integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Kjo pavarësi dhe integritet reflektohet në realizimin e pyetësorëve I cili ruan anonimatit dhe rregullat për ruajtjen e pavarësisë dhe barazisë.						
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë bashkëpunëtor dhe ekspertë të jashtëm si në mënyrë direkte ashtu dhe indirekte. Komisioni I Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka një anëtar ekspert të jashtëm. Gjithashtu institucioni ka dhe një anketim të kompanive që lidhet me reagimet e tyre mbi studentët që zhvillojnë praktikën dhe përshtatjen e njohurive të fituara nga studentët në auditor në përputhje me tregun e punës. Një tjetër kontribut për sigurimin e cilësisë janë dhe leksionet e hapura apo trajnimet e zhvilluara për stafin akademik dhe atë administrative.						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë bashkëpunëtor dhe ekspertë të jashtëm si në mënyrë direkte ashtu dhe indirekte.</i>						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka hartuar dokumentacionin për vlerësimin dhe Sigurimin e Cilësisë së Institucionit dhe programeve të studimit që ajo ofron. Dokumentat janë lehtësisht të aksesueshme dhe në faqen e web www.aeqi.epoka.edu.al ku jepet informacion i detajuar dhe për anëtarët e komisioneve apo njësive përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. <i>2 Statuti I Universitetit Epoka (neni 11,12,35,37, 38,108,109)</i> <i>6 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>8 Direktiva e Universitetit Epoka "Për Vlerësimin e Performanceës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë"</p> <p>12 Politika për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit</p> <p>26 Anketa e Vlerësimit të Instruktorit të lëndës</p> <p>38 Manuali për sigurimin e Cilësisë</p> <p>55 Procedura për anketa të studentëve për ceshje të tjera akademike</p> <p>82 Politika e Cilësisë</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka bërë publike të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm apo të jashtëm si dhe raportet vjetore të përpiluara nga universiteti. Të gjitha dokumentat janë të aksesueshme dhe në web. Institucioni është treguar korrekt në mbrojtjen e privatësisë dhe barazisë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet e vlerësimit të jashtëm • Raportet e vlerësimit të brendshëm • Raportet vjetore
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Universiteti Epoka ka hartuar plane veprimi, procedura dhe ka ngritur njësitë dhe komisionet përkatëse për sigurimin e cilësisë së programit të studimit apo dhe institucionit.</p> <p>Megjithatë, GVJ nuk gjen asnjë document, referencë apo praktikë për planin e masave për këtë program studimi. I vetmi document është shtojcë 80, që jep Vendimet e Senatit për planin në përgjigje të rekomandimeve të ASCAL. Dokumenti shtojcë 80, nuk jep plan veprimi me afate dhe strategji për përmirësim apo përgjigje ndaj rekomandimeve që sduhet të vijnë vetëm nga ASCAL por dhe nga mekanizma të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB Senati Akademik ka miratuar direktivën "Për vlerësimin e Performanceës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë". Ky document përcakton zhvillimin e institucionit, planifikon dhe kordinonon njësitë e ndryshme të brendshme, drejton dhe kontrollon veprimtarinë kërkimore shkencore si dhe veprimtarinë mësimdhënëse.</p> <p>Propozimet për ndryshim lindin në Departament më pas kalojnë në Fakultet, në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulës, komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Senat Akademik.</p> <p>GVJ konstaton se siguri i cilësisë kalon në disa hallka të kordinuara dhe ka një system që funksionon nëpërmjet procedurave të ngritura të cilat janë cituar dhe në standartet e mësipërme.</p> <p>8 Direktiva e Universitetit Epoka "Për Vlerësimin e Performanceës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë"</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentat e dorëzuar si dhe në RVB institucioni prezanton që janë zhvilluar veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin e tyre dhe ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Bazuar në dokumentin shtojcë plotësuese nr 9, rezulton se Universiteti Epoka kryen aktivitete me stafin dhe studentët për rëndësinë e sigurimit të cilësisë.</i></p> <p>9 Trainimet Annex 35 (1)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka bërë publike të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm apo të jashtëm si dhe raportet vjetore të përpiluara nga</p>

	<i>universiteti. Të gjitha dokumentat janë të aksesueshme dhe në web. Institucioni është treguar korrekt në mbrojtjen e privatësisë dhe barazisë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Ekonomiks” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “EPOKA.”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti Epoka, konkretisht Departamenti i Ekonomiksit ka një eksperiencë të gjatë në ofrimin e këtij programi studimi.
2. Departamenti i Ekonomiksit, ka rritur numrin e pedagogëve të brendshëm të kategorisë “Profesor” në vitin akademik 2022-2023 nga dy në tre pedagogë, gjithashtu ka angazhuar të paktën dy pedagogë me kohë të pjesshme që i përkasin kësaj kategorie, për çdo vit akademik, që nga realizimi i akreditimit të parë.
3. Në programin e studimit janë angazhuar pedagogë nga SHBA, Greqia, dhe Turqia. Afrimi i tyre bën të mundur sjelljen e eksperiencave më të mira në procesin mësimor.
4. Universiteti EPOKA, për këtë program studimi ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në kuadrin e programit Erasmus +, gjë që lehtëson shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve.
5. Ofrimi i programit në gjuhën angleze ka bërë të mundur afrimin e një numëri të konsiderueshëm studentësh të huaj.
6. Praktika profesionale është programuar në semestrin e parë të vitit të tretë të studimit, duke krijuar mundësi studentëve të vendosin kontakt me tregun e punës.
7. Sistemi EIS që është sistemi që përdoret gjerësisht nga të gjithë hallkat e Universitetit, është një sistem i mirëstrukturuar dhe eficient në përdorim.

Pika të dobta:

1. Raporti teori -praktikë, për vitin e parë dhe të dytë të studimit është 100% teori dhe 0% praktikë. Për vitin e tretë raporti është 76% teori dhe 24% praktikë. Në planin mësimor të programit të studimit nuk janë të përcaktuara orë seminari ose laborator, në asnjë nga lëndët e ofruara në program. **(Standardi II.3, kriteri 4)** dhe **(Standardi II.4, kriteri 3)**
2. Mënyra e llogaritjes të krediteve. Nuk ka një lidhje të drejtë midis numrit të krediteve të një lëndë dhe ngarkesës në auditor. **(Standardi III.1, kriteri 1)**
- Ka lëndë që për të njëjtën ngarkesë në auditor kanë 5 ECTS dhe disa lëndë të vitit të tretë kanë 6 ECTS.
- Ka lëndë që kanë një ngarkesë të ndryshme në auditor dhe të njëjtën numër kreditesh.
3. Programi i studimit, ka angazhuar një numër të konsiderueshëm asistent lektorësh, për dhënien e leksioneve. Konstatimi qendron për të gjitha vitet akademike pas realizimit të akreditimit të parë të programit të studimit. **(Standardi II.3, kriteri 1)**
4. Në syllabuset e paraqitura nga institucioni, literatura e përdorur nga disa module të programit nuk është e 5 viteve të fundit. Gjithashtu në shumë module mungon literatura shtesë. **(Standardi IV.3, kriteri 1)**
5. Mungesa e një plani të detajuar për shtimin e titujve në bibliotekë në mbështetje të kërkesave të departamenteve. Kjo sigurisht lidhet dhe me pikën 4, ku literatura më e fundit nuk është reflektuar në syllabuse. **(Standardi IV.3 , kriteri 3 ,4)**



6. Ngarkesa mësimore ndahet sipas nevojave të institucionit dhe jo sipas gradave apo titujve. Gjithashtu konstatohet dhe përfshirja e stafit akademik në komisione të ndryshme të ngritura nga institucioni dhe njëkohësisht kryerja e punëve administrative. (**Standardi IV.1, kriteri 2**)

Rekomandime:

1. Rekomandojmë, rritjen e orëve praktike në syllabus. Në pjesën më të madhe të lëndëve mungojnë ushtrimet, seminarët ose orët e laboratorit.
2. Llogaritja e ngarkesës në auditor të bazohet vetëm në javët për zhvillimin e veprimatrive formuese (14 javë) dhe jo provimet (2 javë). Rekomandojmë që të rishikohen orët jashtë auditorit. Duhet të vendoset një korespondencë e drejtë midis ngarkesës në auditor dhe krediteve të lëndës.
3. Rekomandojmë që leksionet e programit të studimit të mbulohen nga stafi akademik i kategorisë lektor.
4. Rekomandojmë që lëndët "Historia e mendimit ekonomik" dhe "Financat publike" të jenë lëndë të detyruara dhe jo me zgjedhje, duke ndjekur modelet më të mira në botë.
5. Për të pasur të ardhura të qëndrueshme institucioni duhet të hartojë plane afatmesme apo dhe afatgjata. Mungesa e një strategjie zhvillimi çënon qëndrueshmërinë financiare.
6. Biblioteka të punojë dhe në orare më të zgjatura përtej orarit zyrtar të punës sidomos në kohë sezoni provimesh kur nevojat e studentëve janë më të mëdha.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Economics" provided by the Higher Education Institution "EPOKA University"

Strengths and affirmations

1. Department of Economics of EPOKA University, has a long experience in providing this study program.
2. Department of Economics has increased the number of full-time lecturers that belongs to "Professor" category for the academic year 2022-2023, from two lecturer to three lecturer, and has involved as part time lecturer at least two lecturer that belong this category, for every academic year since the last accreditation.
3. In the study program are involved foreign lecturer from the USA, Greece and Turkey. They enrich the study program with the best teaching practices from abroad.
4. For this study program, EPOKA University has signed many agreements in the framework of Erasmus + program, that have facilitated the exchange of academic staff and students.
5. The language of the study program "English" has facilitated the involvement of a considerable number of foreign students.
6. Professional practice is programed in the first semester in the third year of studies, by creating possibilities for the students to be in contact with the labor market before the end of the studies.
7. The EIS system is broadly used in EPOKA University, is well structured and efficient.


Weaknesses

1. The theoretical and practical teaching hours for the first and second year of studies are 100% theoretical teaching hours and 0% practical teaching hours. In the third year of studies, theory accounts for 76% of total teaching hours and practice for 24%. In the study program are not determined seminars or laboratory hours, in none of the offered courses. (**Standard II.3, criteria 4**) and (**Standard II.4, criteria 3**)

2. The way the credits (ECTS) are determined. There is not a correspondence between ECTS and teaching load. **(Standard III.1, criteria 1)**
 - There are courses that have the same teaching load and have 5 ECTS in the first and second year of the study, and 6 ECTS in the third year of the study.
 - There are courses that have a different teaching load but have the same number of credits (ECTS).
3. The study program has engaged a considerable number of assistant lectures (MSc), for teaching lessons. The finding is true for every academic year after the first accreditation of the study program. **(Standard II.3, criteria 1)**
4. The syllabuses of some courses have not updated literature from the last 5 years. Additional literature is missing in many modules. **(Standard IV.3, criteria 1)**
5. There is not implemented an action plan for supporting departments requirement for new teaching literature. This is also related to point 4, the updated literature is not reflected in the syllabus. **(Standard IV.3 , criteria 3 ,4)**
6. The teaching load is according to the institution's needs and not according to academic titles and qualifications. The involvement of academic staff in various commissions and administrative work is not followed by a decrease in teaching load. **(Standard IV.1, criteria 2)**

Recommendation

1. We recommend increasing the practical teaching hours in the syllabus. In the teaching program quite in all the courses are not determined exercise hours, seminars, or laboratory hours only lessons.
2. Teaching hours (load) to be based only on 14 weeks that are determined for teaching activities and not to include 2 weeks of final exams. We recommend reconsidering the individual study hours, to have a fair correspondence between the teaching hours and the number of credits (ECTS) that a course has.
3. We recommend that only the academic staff that hold at least a PhD (lecturer) teach lessons in the study program.
4. We recommend that "History of economic thought" and "Public finance" to be obligatory courses and not elective courses, following the best world practices.
5. To have income sustainability the institutions must implement medium run and long run strategies. The lack of development strategy threatens financial sustainability.
6. The library must work beyond the official time 4PM, especially during the exams when the students' needs are higher.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen kryesisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X